



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

UDHËZUES KURRIKULAR LËNDOR PËR GJUHËN SHQIPE

Material ndihmës për mësuesit e gjuhës shqipe në arsimin e mesëm të ulët



KLASAT 6-9

TIRANË, 2018

Përgatiti udhëzuesin:

Erida Koleci, IZHA

Kontribuan:

Natasha Kazmaj, shkolla “New York High School”, Tiranë

Afërdita Skura, shkolla “Hasan Prishtina”, Tiranë

Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës “Gjuhë shqipe” në arsimin e mesëm të ulët është produkt i konsultimeve dhe i diskutimeve me mësues dhe me specialistë të kësaj lënde në këtë cikël shkollimi.

Prodhim i IZHA-s, 2018

www.izha.edu.al

Copy right © IZHA

TABELA E PËRMBAJTJES

1.	HYRJE.....	4
2.	QËLLIMET E UDHËZUESIT LËNDOR.....	4
3.	RËNDËSIA E LËNDËS SË GJUHËS SHQIPE NË ARSIMIN E MESËM TË ULËT	6
3.1	Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” dhe lënda e gjuhës shqipe.....	6
3.2	Kompetencat e lëndës së gjuhës shqipe.....	6
3.3	Tematikat e lëndës së gjuhës shqipe.....	7
4	Koha mësimore.....	7
5	QËLLIMET E PROGRAMIT TË LËNDËS SË GJUHËS SHQIPE NË KLASAT VI- IX....	9
6	RISITË E PROGRAMIT TË GJUHËS SHQIPE	9
7	ZHVILLIMI I KOMPETENCAVE KYÇ NËPËRMJET LËNDËS SË GJUHËS SHQIPE.	12
8	MODELE TË INTEGRIMIT NDËRLËNDOR MES GJUHËS SHQIPE DHE LËNDËVE TË TJERA	14
9	METODOLOGJIA PËR ZHVILLIMIN E LËNDËS SË GJUHËS SHQIPE	15
9.1	Strategjitë e të lexuarit.....	16
9.2	Fazat e të shkruarit.....	18
9.3	Metodat dhe teknikat mësimore që mund të përdoren në lëndën e gjuhës shqipe	21
10	PLANIFIKIMI NË LËNDËN E GJUHËS SHQIPE	47
10.1	Llojet e planifikimeve	47
10.2	Planifikimi vjetor i lëndës	48
10.3	Planifikimi sipas periudhave	51
10.4	Planifikimi ditor	55
10.5	Modele planifikimi ditor (me orë të njëpasnjëshme 45 +45).....	56
11.	VLERËSIMI I NXËNËSVE NË LËNDËN E GJUHËS SHQIPE.....	63
11.1	Nivelet e arritjeve	64
11.2	Vlerësimi i vazhduar	64
11.3	Vlerësimi me portofol lëndor	67
11.4	Vlerësimi me test ose detyrë përmbledhëse	69
11.5	Vlerësimi periodik.....	85
11.6	Vlerësimi përfundimtar	85
11.8	Vlerësimi i esesë.....	87
11.9.	Ndryshime pozitive që sjell vlerësimi i bazuar në kompetenca	91
	Bibliografia.....	92

1. HYRJE

Thomas Eliot ka thënë se nuk ka asgjë të përhershme, përveç ndryshimit. Në fakt, ato që po e karakterizojnë sot, botën dhe njerëzimin janë ndryshimet e shpejta, si: zhvillimi i teknologjisë, kërkesat e reja në tregun e punës, marrëdhëniet në shoqëri, aspiratat njerëzore në shekullin e ri etj. Pa dyshim që këtyre ndryshimeve, arsimit duhet t'u përgjigjet me ritme të shpejta e cilësore.¹

E ardhmja kërkon që individit të jetë nxënës përgjatë gjithë jetës, të ketë aftësi të mira komunikimi, të përdorë në mënyrë të efektshme teknologjinë, të jetë i aftë të zgjidhë probleme, të zhvillojë mendimin kritik dhe krijues, të ndërmarrë nisma dhe iniciativa etj. Të gjitha këto lidhen me konceptin e kompetencave për të nxënësit gjatë gjithë jetës, të cilat mundësojnë përgatitjen e individëve për të qenë të suksesshëm në jetën personale, sociale dhe profesionale². Arsimit, në përgjithësi, dhe kurrikula, në veçanti, duhet të synojnë formimin e këtyre kompetencave. Ky është fokusi kryesor i reformës së re kurrikulare, e cila përfshiu të gjitha ciklet e arsimit parauniversitar, si dhe të gjitha fushat dhe lëndët mësimore.

Pjesë e kësaj reforme janë edhe programet e gjuhës shqipe. Gjuha shqipe është lënda kryesore që ndikon në zhvillimin intelektual, shoqëror, estetik dhe emocional të nxënësve. Ajo i pajis nxënësit me njohuri, aftësi, vlera dhe qëndrime, të cilat janë përcaktuese jo vetëm për arritjet e tyre në çdo fushë dhe lëndë mësimore, por edhe për të qenë të suksesshëm në botën përtej shkollës. Duke qenë kaq të rëndësishme në jetën njerëzore, gjuha shqipe është trajtuar si e tillë edhe në kurrikulën e shkollës.

Në procesin e zbatimit të programeve të reja janë të nevojshme mbështetja dhe udhëzimet e vazhdueshme për mësuesit. Pjesë e kësaj mbështetjeje është edhe hartimi i udhëzuesit lëndor për mësuesit e gjuhës shqipe të arsimit të mesëm të ulët (klasat 6-9).

2. QËLLIMET E UDHËZUESIT LËNDOR

Udhëzuesi lëndor është një material ndihmës për mësuesit e gjuhës shqipe të klasave 6-9. Ai ka për qëllim:

- të zbërthejë dhe të sqarojë kërkesat e programit lëndor;
- të orientojë mësuesit në procesin e planifikimit (planit vjetor lëndor, planit të periudhës dhe planit ditor);

¹ Korniza Kurrikulare e arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, 2014. IZHA

- të udhëzojë mësuesit në procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve, duke u bazuar në rezultatet e të nxënësve të kompetencave kyç dhe të kompetencave lëndore, si dhe në nivelet e arritjeve;
- të ndihmojë mësuesit në përzgjedhjen e teknikave, strategjive dhe metodave mësimore që synojnë të zhvillojnë kompetencat e lëndës dhe kompetencat kyç;
- të udhëzojë mësuesit që të përzgjedhin burime të ndryshme të nxëni për të përmbushur kërkesat e programit lëndor.

Përdoruesit e udhëzuesit janë mësuesit, specialistët e arsimit dhe fakultetet e mësuesisë etj.

- *Mësuesit* do ta përdorin udhëzuesin lëndor që të orientohen se si duhet ta ndërtojnë mësimdhënien për të pajisur nxënësit me kompetencat kyç dhe kompetencat e lëndës, si dhe për të përmbushur kërkesat e programit.
- *Specialistët e arsimit* mund ta përdorin udhëzuesin lëndor për qëllime monitorimi, vlerësimi, studimi etj.
- *Fakultetet e mësuesisë* mund ta përdorin udhëzuesin lëndor për përgatitjen efektive të mësuesve të ardhshëm të gjuhës shqipe, si dhe mund ta rekomandojnë për praktikën profesionale të studentëve.

Struktura e udhëzuesit është pasqyruar më poshtë.

Udhëzuesi:

- përshkruan rëndësinë e lëndës shqipe në arsimin e mesëm të ulët;
- përshkruan kompetencat që zhvillon lënda e gjuhës;
- liston risitë e programit të gjuhës shqipe;
- jep udhëzime për metodat dhe teknikat mësimore që mund të përdoren për të zhvilluar kompetencat kyç dhe lëndore;
- përshkruan risitë në procesin e planifikimit dhe llojet e planeve mësimore që duhet të hartojë mësuesi;
- ofron modele planesh vjetore, modele planesh të periudhave dhe modele orësh mësimi;
- shtjellon teknikat dhe instrumentet e vlerësimit të nxënësit;
- ofron modele testesh, projektesh dhe portofolësh lëndore.

Udhëzuesi përqendrohet më shumë te shembujt, modelet dhe ilustrimet, në mënyrë që t'i shërbejë sa më mirë veprimtarisë së përditshme të mësuesit.

3. RËNDËSIA E LËNDËS SË GJUHËS SHQIPE NË ARSIMIN E MESËM TË ULËT

3.1 Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” dhe lënda e gjuhës shqipe

Lënda e gjuhës shqipe bën pjesë në fushën “Gjuhët dhe komunikimi”. Kjo fushë i aftëson nxënësit që të përdorin saktë gjuhën për të komunikuar, për të plotësuar interesat e tyre personale, si dhe për të përmbushur kërkesat e shoqërisë dhe të tregut të punës.

Mësimi i gjuhës shqipe zhvillon te nxënësit të menduarit kritik dhe i bën të vetëdijshëm për identitetin e tyre personal dhe kombëtar. Nëpërmjet leximit të teksteve nga letërsia shqipe dhe ajo botërore, nxënësit zhvillojnë botën e tyre emocionale, pasurojnë përfytyrimet dhe imagjinatën e tyre për botën, çmojnë dhe vlerësojnë gjuhën e kulturën kombëtare dhe ato botërore.

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” nxit dëshirën dhe kuriozitetin e nxënësve për t’u bërë lexues aktivë e të pavarur dhe shkruar të saktë, origjinalë dhe krijues. Po kështu, ajo zhvillon te nxënësit njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat e duhura që ata të flasin dhe të dëgjojnë në mënyrë korrekte në varësi të situatës dhe të qëllimit që kanë.

Arritjet gjuhësore të nxënësve janë përcaktuese jo vetëm për lëndët e fushës “Gjuhët dhe komunikimi”, por dhe për çdo lëndë që zhvillohet në shkollë. Nëse nxënësit nuk janë të aftë të dëgjojnë, të flasin, të lexojnë dhe të shkruajnë mirë, ata nuk mund të jenë të suksesshëm në shkollë dhe në jetë. Duke pasur një rëndësi të tillë, fusha dhe lëndët që e përbëjnë atë, janë një nga detyrat parësore të arsimit bazë.

3.2 Kompetencat e lëndës së gjuhës shqipe

Korniza kurrikulare përcakton si qëllim kryesor zotërimin e kompetencave kyç nga nxënësit. Ndërtimi dhe zhvillimi i këtyre kompetencave kyç janë të domosdoshëm për një individ, me qëllim që të përmbushë me sukses kërkesat personale, shoqërore dhe profesionale. Çdo fushë të nxëni dhe lëndë synon që ta pajisë nxënësin me këto kompetenca. Këtë “mision”, lënda e realizon nëpërmjet ndërtimit dhe zhvillimit të kompetencave të saj. Bazuar në synimet dhe specifikat e lëndës së gjuhës shqipe, pesë kompetencat e saj janë:

- Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme.
- Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar.
- Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare.
- Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale.
- Përdorimi i drejtë i gjuhës.

Kompetencat zhvillohen përmes disa **tematikave**. Tematikat dhe renditja e tyre nuk nënkuptojnë që realizimi i tyre përgjatë vitit shkollor ose shkallës të zhvillohet e ndarë në këtë renditje. Kombinimi dhe ndarja e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve në orë mësimi, kapituj apo grupe temash e njësi mësimore, si dhe renditja e tyre është e drejtë e përdoruesve të programit (më kryesorët janë mësuesit dhe autorët e teksteve). Më poshtë janë dhënë tematikat për çdo kompetencë.

3.3 Tematikat e lëndës së gjuhës shqipe

Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme

- Rregullat e të dëgjuarit.
- Të dëgjuarit për të kuptuar dhe për të vlerësuar tekstin.

Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar

- Rregullat dhe organizimi i të folurit.
- Diskutimi dhe bashkëveprimi në grup.

Të lexuarit e teksteve të ndryshme letrare dhe joletrare

- Të lexuarit për të kuptuar.
- Të lexuarit e teksteve letrare.
- Të lexuarit e teksteve joletrare.

Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

- Planifikimi, organizimi, rishikimi dhe redaktimi i të shkruarit.
- Të shkruarit për qëllime personale.
- Të shkruarit për qëllime funksionale.

Përdorimi i drejtë i gjuhës

- Sintaksë.
- Morfologji.
- Leksikologji dhe semantikë.
- Drejtshkrim.
- Fonetikë dhe fonologji.

4 Koha mësimore

Gjuha shqipe është lëndë e detyrueshme në arsimin bazë. Ajo zhvillohet përgjatë nëntë viteve të këtij arsimit dhe zë afërsisht 1/4 e kurrikulës. Në përfundim të klasës së nëntë, lënda e gjuhës

shqipe është pjesë e provimeve kombëtare të arsimit bazë. Në tabelën e mëposhtme është dhënë koha mësimore gjatë shkallës së tretë dhe shkallës së katërt (klasat VI-IX).

Klasa/ shkalla	Klasa VI	Klasa VII	Shkalla III	Klasa VIII	Klasa IX	Shkalla IV
Orë/javë	5	5	10	5	5	10
Orë gjithsej	175	175	350	175	175	350

Nxënësit, në lëndën e gjuhës shqipe, pothuajse çdo orë flasin, dëgjojnë, lexojnë, shkruajnë dhe fitojnë njohuri dhe shkathtësi rreth sistemit gjuhësor. Megjithatë, theksi vihet në njërin nga këto kompetenca. Ky fakt përcakton edhe orët për këtë kompetencë. P.sh., në klasën e gjashtë janë përcaktuar rreth 25 orë për kompetencën “Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale”. Kjo do të thotë që nxënësit do të shkruajnë, pothuajse në çdo orë mësimi, por theksi në këto 25 orë do të vihet më shumë te kjo kompetencë.

Kompetencat/ klasat	Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme	Të folurit për të komunikuar dhe për të	Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare	Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Provimet kombëtare të arsimit bazë	Totali
Klasa e gjashtë	10	10	70	25	60		175
Klasa e shtatë	10	10	70	25	60		175
SHKALLA E TRETË	20	20	140	50	120		350
Klasa e tetë	8	7	70	25	65		175
Klasa e nëntë³	8	7	65	20	60	15	175
SHKALLA E KATËRT	16	14	135	45	125	15	350

³ Në këtë klasë, 15 orë mësimore janë lënë (sugjerim) për përgatitjen e nxënësve për provimet kombëtare të arsimit bazë.

5 QËLLIMET E PROGRAMIT TË LËNDËS SË GJUHËS SHQIPE NË KLASAT VI- IX

Nxënësit:

- komunikojnë qartë dhe saktë (me gojë dhe me shkrim) në varësi të qëllimit dhe të situatës;
- shprehin opinionet e tyre, në mënyrë korrekte nga ana gjuhësore, gjatë diskutimeve dhe gjatë punëve në grup;
- dëgjojnë, lexojnë dhe kuptojnë lloje të ndryshme tekstesh, nxjerrin përfundime dhe i vlerësojnë këto tekste (me gojë ose me shkrim);
- gjejnë informacion në media dhe në internet, e gjykojnë në mënyrë kritike këtë informacion dhe e përdorin atë në mënyrën e duhur;
- njohin llojet e ndryshme të teksteve dhe përdorimet e tyre, si dhe hartojnë e prezantojnë tekste të ndryshme;
- lexojnë tekste letrare të gjinive të ndryshme dhe zhvillojnë botën emocionale përmes tyre;
- kuptojnë, interpretojnë dhe analizojnë tekste letrare si një burim për të njohur histori të ndryshme, marrëdhëniet njerëzore, ndjenjat, vlerat etj.;
- përdorin gjuhën standarde në shkollë dhe jashtë saj, si dhe zbatojnë rregullat gramatikore themelore;
- vlerësojnë letërsinë si pjesë e rëndësishme e kulturës kombëtare dhe botërore;
- vlerësojnë rëndësinë e gjuhës shqipe si vlerë e kulturës kombëtare.

6 RISITË E PROGRAMIT TË GJUHËS SHQIPE

Së pari, duhet thënë që programi i gjuhës shqipe është hartuar në frymën dhe në filozofinë e kurrikulës së re, e cila synon ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave kyç dhe të kompetencave lëndore tek nxënësit. Përmbajtja lëndore konceptohet si mjet për realizimin e kompetencave kyç dhe atyre të lëndës nëpërmjet të situatave të ndryshme të të nxënit. Kjo nënkupton që nxënësit aktivizojnë njohuritë e mëparshme, ndërtojnë njohuri dhe aftësi të reja duke ndërvepruar me tekstet (letrare dhe jo letrare), i integrojnë dhe i lidhin idetë e teksteve me jetën e tyre dhe me botën që i rrethon, i përdorin njohuritë në situata të reja etj.

Hartimi i programeve të gjuhës shqipe nga klasa përgatitore deri në klasën XII, ka siguruar koherencën vertikale të njohurive, aftësive, qëndrimeve dhe vlerave të nxënësve. Kjo do të thotë që është shmangur mbingarkesa ose përsëritjet e tepërta të njohurive në klasa të ndryshme.

Në program përcaktohen hapat që duhet të ndjekë mësuesi gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies për të lidhur kompetencat e lëndës me kompetencat kyç për secilën shkallë. Gjithashtu,

jepen në mënyrë specifike rezultatet e të nxënësve të kompetencave kyç që realizohen nëpërmjet lëndës brenda një shkalle mësimore. Me specifikat dhe hapësirat që ka, lënda lejon edhe krijimin e situatave mësimore të cilat mundësojnë trajtimin e temave ndërkurrikulare: Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave; Të drejtat e njeriut; Vendimmarrja morale; Mjedisi dhe bashkëjetesa paqësore.

Programi i gjuhës shqipe është organizuar në bazë shkalle mësimore. Njohuritë janë dhënë për vit mësimor, ndërsa aftësitë/shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet janë dhënë për shkallë mësimore. Kjo mënyrë organizimi i jep më shumë fleksibilitet mësuesit që të ndërtojë punën për zhvillimin e aftësive/ shkathtësive jo brenda një viti, por brenda një shkalle.

Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme është përcaktuar si kompetencë më vete (njohuri, aftësi/ shkathtësi, vlera dhe qëndrime) duke krijuar mundësinë që nxënësi të zhvillojë aftësitë për të kuptuar dhe për të mbajtur qëndrim kritik ndaj tekstit që dëgjon.

Në kompetencën “Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar” sugjerohen tema për të cilat mund të organizohen diskutime ose prezantime me nxënësit. Në këtë kompetencë vihet theksi te diskutimi dhe bashkëveprimi në grup dhe te njohuritë e aftësive/shkathtësive të nevojshme për të bërë një prezantim. Duke ditur sa të rëndësishme janë për jetën e përditshme këto aftësi/ shkathtësi, kjo risi e programit është shumë e vlefshme.

Në kompetencën “Të lexuarit e teksteve të ndryshme letrare dhe jolettrare” theksi vihet te strategjitë e të lexuarit, të cilat synojnë që nxënësi të bëhet një lexues i pavarur dhe kritik. Gjithashtu, në program është sugjeruar edhe përqindja e teksteve letrare (70 %) dhe e teksteve jolettrare (30%), me qëllim që nxënësit t’i jepet mundësia që të punojë me lloje të ndryshme tekstesh dhe ta ketë më të lehtë kalimin në shkollën e mesme, ku merren njohuri shumë më të thelluara për tekstet. Gjithashtu, në program është sugjeruar edhe zhvillimi i bisedave letrare ose i leximeve jashtë klase. Qëllimi i tyre është që nxënësit të zgjedhin libra dhe të punojnë në mënyrë të pavarur me studimin e një teksti. Për zgjedhjen e librave të bisedave letrare janë sugjeruar listat rekomanduese të MASR-së.

Është e rëndësishme që gjatë këtyre orëve, nxënësve t’u krijohet mundësia të zgjedhin edhe vepra që janë të pëlqyera e të preferuara për ta.

Veprat e rekomanduara për lexime jashtë klase duhet të jenë:

- nga letërsia shqipe dhe letërsia botërore;
- nga autorë të periudhave të ndryshme;
- nga gjini dhe lloje të ndryshme letrare.

Përzgjedhja e leximeve jashtë klase nga autorë të ndryshëm, periudha të ndryshme, nga gjini dhe lloje të ndryshme letrare krijon mundësi për pasurimin e përvojës letrare së nxënësve.

Te kompetenca “Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale” theksi vihet te procesi i të shkruarit duke përcaktuar aftësitë/shkathtësitë që duhet të demonstrojë nxënësi gjatë çdo faze të të shkruarit. Arsyeja pse programi i jep rëndësi edhe procesit të të shkruarit, jo vetëm produktit, është që të japë mundësinë që nxënësi të aftësohet të shkruajë në mënyrë të pavarur, duke ndjekur të gjitha fazat e këtij procesi.

Në programin e gjuhës shqipe i është lënë hapësirë, përvetësimit të rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe atyre të pikësimit. Mirëpo duhet kuptuar qartë fakti që gjuha nuk është vetëm gramatikë dhe se gramatika është vetëm një pjesë e gjuhës. Natyrisht që një përdorues i mirë i shqipes, është ai që e zotëron standardin dhe rregullat e gramatikës, por nëse kurrikula e re do të fokusohet vetëm te gramatika, formimi gjuhësor i nxënësve do të ishte i përciptë. Rregullat e thata gramatikore, pa i konkretizuar në gjuhën e folur ose të shkruar, do ta bënin gjuhën shqipe për nxënësit, të huaj, megjithëse ajo është amtare për ata. Prandaj, në program është sugjeruar që njohuritë gramatikore, rregullat e drejtshkrimit dhe të pikësimit duhet të integrohen me studimin e teksteve letrare dhe jolettrare. Gjithashtu, te kompetenca “Përdorimi i drejtë i gjuhës” ka lehtësim njohurish që mund të konsiderohen të vështira për moshën dhe zhvillimin e nxënësve.

Mësuesi që punon me kurrikulën e re ka më shumë liri dhe fleksibilitet. Kështu ndarja e orëve nuk është e detajuar dhe është sugjeruese. Mësuesi është i lirë të vendosë vetë për sasinë e orëve:

- për projekte;
- për përsëritje;
- për biseda letrare;
- për diktime;
- për vlerësimin e portofoleve të nxënësve;
- etj.

Kjo bën që mësuesi të përshtatë mësimdhënien në varësi të specifikave të klasës dhe të nivelit të nxënësve.

7 ZHVILLIMI I KOMPETENCAVE KYÇ NËPËRMJET LËNDËS SË GJUHËS SHQIPE

Zhvillimet e sipërpërmendura dhe nevojat për ndryshime arsimore e bëjnë të qartë domosdoshmërinë për të nxënë gjatë gjithë jetës. Qytetarëve të shoqërisë së dijes u nevojitet të zhvillojnë njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet vetjake, shoqërore dhe ato që lidhen me botën e punës dhe tregun e lirë. Procesi i arsimit do t'i mundësojë çdo nxënësi zotërimin e kompetencave kyç, të nevojshme për jetën dhe për punën. Kompetencat kyç janë ato që i nevojiten një individ për zhvillimin e tij personal, për punësimin, për përfshirjen në jetën sociale si qytetar aktiv, si dhe për përshtatjen në botën digjitale.

Në përputhje me qëllimet e arsimit parauniversitar, këto kompetenca janë:

- Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit (*Nxënësi komunikon në mënyrë efektive.*)
- Kompetenca e të menduarit (*Nxënësi mendon në mënyrë krijuese.*)
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë (*Nxënësi mëson për të nxënë.*)
- Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (*Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive.*)
- Kompetenca personale (*Nxënësi bën jetë të shëndetshme.*)
- Kompetenca qytetare (*Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.*)
- Kompetenca digjitale (*Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.*)

Zhvillimi i kompetencave kyç nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies –nxënies nuk është një proces i veçantë, por mësuesi mban parasysh lidhjen e kompetencave kyç, me kompetencat gjuhësore. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë situatat e të nxënës, veprimtaritë, metodat dhe mjetet e përshtatshme për procesin e të nxënës. Kur nxënësi realizon kompetencat gjuhësore, ai njëkohësisht është duke zhvilluar edhe kompetencat kyç.

Shembujt e mëposhtëm të zhvillimit të kompetencave kyç nëpërmjet zhvillimit të kompetencave gjuhësore dhe përmbajtjes së lëndës nuk janë shteruese. Ato pasurohen nga vetë mësuesit.

KOMPETENCA	SHEMBUJ
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit	- Çdo orë e lëndës së gjuhës shqipe kontribuon në ndërtimin dhe në zhvillimin e kompetencës së komunikimit dhe të të shprehurit.
Kompetenca e të menduarit	P.sh.: - Nxënësit shprehin mendimet e tyre rreth pyetjes “Pse një udhëheqës duhet të jetë tolerant dhe të dijë të falë?”, pasi ata kanë lexuar një tekst, që trajton figurën e një udhëheqësi. Ata argumentojnë mendimet e tyre.

	- Nxënësit gjejnë dallimet dhe ngjashmëritë mes një poezie të Naim Frashërit dhe një poezie të Gjergj Fishtës për gjuhën shqipe. - Nxënësit krahasojnë dy reportazhe të ndryshme për mënyrën se si e trajtojnë ato një problem social. - Nxënësit analizojnë dy artikuj gazetash që trajtojnë të njëjtën tematikë ose të njëjtën çështje dhe përcaktojnë ku artikujt bashkohen dhe ku ndryshojnë nga njëri-tjetri - Nxënësit japin argumentet e tyre rreth përdorimit ose jo të fjalëve të huaja gjatë komunikimit (P.sh.: <i>Pse nuk duhet përdorur fjala “fokusohem”? Me cilën fjalë të gjuhës shqipe mund ta zëvendësojmë? Po fjalën “internet” a duhet ta përdorim? Pse?</i>).
Kompetenca e të mësuarit për të nxënë	P.sh.: - Gjatë fazës së planifikimit për çdo punë me shkrim, nxënësit kujtojnë njohuritë që kanë rreth temës që do të shkruajnë; përdorin burime të ndryshme për të mbledhur informacion; studiojnë modele të mira shkrimi që kanë trajtuar të njëjtën temë ose subjekt; përdorin bibliotekën e shkollës ose internetin për të mbledhur informacion për punën me shkrim; përzgjedhin dhe klasifikojnë informacionet e mbledhura etj., pra aftësohen të përdorin strategjitë e të nxënit. - Nxënësit përdorin disa strategji (para, gjatë dhe pas leximit) për të kuptuar tekstin, si p.sh.: aktivizojnë njohuritë e mëparshme nëpërmjet një diskutimi në grup; parashikojnë se çfarë do të ndodhë më pas duke dhënë arsyetime dhe argumente për parashikimin e tyre; analizojnë elementet që shoqërojnë tekstet (piktura, ilustrime, lista, tabela, harta etj.) për të kuptuar më mirë tekstin etj.
Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin	P.sh.: - Nxënësit shkruajnë poster (<i>deri në 140 fjalë</i>) për ruajtjen e mjedisit nga ndotja. Ata japin komentet, sugjerimet dhe vlerësimet e tyre për punët e njëri-tjetrit.
Kompetenca personale	P.sh.: - Nxënësit shprehin me shkrim ose me gojë përvojën e tyre, pasi kanë ndihmuar një bashkëmoshatar ose një anëtar të komunitetit që ka pasur probleme shëndetësore, sociale, ekonomike etj.
Kompetenca qytetare	P.sh.: - Për legjendën e murimit, nxënësit gjykojnë për vendimin e padrejtë të vëllezërve për ta sakrifikuar Rozafën. - Për t'u aftësuar të shkruajnë një tekst udhëzues, nxënësit shkruajnë rregulloren e klasës. Përveç njohurive rreth strukturës dhe karakteristikave kryesore të një rregulloreje, nxënësit marrin përsipër të formulojnë të drejtat dhe detyrimet e tyre në klasë.
Kompetenca digjitale	P.sh.: - Nxënësit shkruajnë në Word një njoftim ose një ftesë formale, p.sh., një ftesë për ceremoninë e mbarimit të shkollës 9-vjeçare. - Nxënësit bëjnë një prezantim në Power point për rëndësinë e gjuhës standarde shqipe.

8 MODELE TË INTEGRIMIT NDËRLËNDOR MES GJUHËS SHQIPE DHE LËNDËVE TË TJERA

Mësimi i gjuhës shqipe në shkollë mbështet edhe ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave të fushave/lëndëve të tjera të kurrikulës. Në lëndën e gjuhës shqipe, nxënësit fitojnë njohuri, aftësi, shkathtësi, vlera dhe qëndrime për të komunikuar me gojë dhe me shkrim; lexojnë dhe kuptojnë tekste të llojeve të ndryshme; pasurojnë fjalorin dhe botëkuptimin e tyre duke lexuar tekste letrare dhe joletrare; mësojnë të shkruajnë tekste të ndryshme (opinione, raporte, udhëzime etj.); mësojnë ta përdorin drejt nga ana gramatikore dhe drejtshkrimore gjuhën etj. Të gjitha këto njohuri, shkathtësi, vlera dhe qëndrime sigurojnë suksesin e nxënësve edhe në fushat dhe lëndët e tjera. Nga ana tjetër, edhe lënda e gjuhës shqipe lidhet dhe integrohet me lëndët e tjera. Integrimi ndërlëndor shmang marrjen e njohurive të fragmentuara dhe të shkëputura nga jeta e përditshme. Më poshtë janë dhënë disa shembuj të integrimit të gjuhës shqipe me lëndët e tjera. Mësuesi, pothuajse gjatë çdo ore mësimi, duhet të krijojë mundësi për integrim ndërlëndor.

Gjuha shqipe dhe gjuhët e huaja

- Fjalët e huaja në leksikon e gjuhës shqipe si p.sh.: *A mund të thoni disa fjalë të huaja, të cilat janë të panevojshme dhe e dëmtojnë gjuhën shqipe? (i avancuar- i përparuar, aprovoj-miratoj, dimension- përmasë, aplikoj-zbatoj etj.) Cilat fjalë të huaja kanë mbetur në gjuhën tonë?* (Fjalët që kanë hyrë për të shënuar sende ose dukuri të reja, si p.sh.: kompjuter, televizor, energji, identitet, standard etj.).
- Krahasimi mes dy varianteve të një teksti, në shqip dhe në gjuhë të huaj.

Gjuha shqipe dhe matematika

- Shkrimi njësh i numërorëve themelorë që nga njëmbëdhjetë deri më nëntëmbëdhjetë, i numërorëve që tregojnë dhjetëshe, qindëshe, si edhe i numërorëve rreshtorë, pavarësisht nga numri i pjesëve përbërëse të tyre.
- Shkrimi ndaras i numërorëve themelorë, të formuar me pjesëmarrjen e fjalëve *mijë, milion, miliard etj.*, dhe i pjesëve përbërëse të një numërori themelor, të lidhura me lidhëzën e.
- Shkrimi i numërorëve rreshtorë, kur vetë numri ose një pjesë e tij shënohet me shifra arabe (klasa e 2- të). Shkrimi i numërorëve rreshtorë me shifër romake (klasa I).
- Shkrimi i shenjës % pas një numri me shifra.

Gjuha shqipe dhe historia

- Ndikimi i kushteve historike e shoqërore në letërsinë e Rilindjes Kombëtare (p.sh., në poemën “Bagëti e bujqësi” të Naim Frashërit).
- Vlerësimi i kontributit të Skënderbeut nëpërmjet diskutimit të një fragmenti nga romani “Kështjella” i Ismail Kadaresë.

Gjuha shqipe dhe qytetaria

- Angazhimi në një nismë për të ndihmuar fëmijët jetimë, pas diskutimit të një teksti letrar që trajton një temë të tillë.
- Kthimi i një letre joformale në një letër formale (p.sh., përdorimi i njëjësit dhe i shumësit, leksiku i ndryshëm etj.).

Gjuha shqipe dhe arti pamor

- Përdorimi i mjeteve pamore (foto, piktura, ilustrime) në shkrimin e një reklame.
- Shprehja e përjetimeve nga leximi i një teksti në formën e një vizatimi.
- Funkcioni i fotove ose i ilustrimeve në një tekst. (*Çfarë mendoni kur shihni këtë foto? A e kishin përfytyruar edhe ju kështu personazhin? Për çfarë ju ndihmon figura në tekst?*)

Gjuha shqipe dhe muzika

- Shoqërimi me muzikë i një loje me role.
- Përzgjedhja e një muzike në varësi të gjendjes shpirtërore të personazhit.
- Shkrimi dhe prezantimi i një reportazhi, duke përdorur edhe muzikën, përveç tekstit dhe mjeteve pamore.

9 METODOLOGJIA PËR ZHVILLIMIN E LËNDËS SË GJUHËS SHQIPE

Strategjitë, metodat dhe teknikat e mësimdhënies përfaqësojnë procedura standarde didaktike, të cilat përdoren nga ana e mësuesve në bashkëpunim me nxënësit për prezantimin dhe zhvillimin e aktiviteteve mësimore, me qëllim përmbushjen e rezultateve të të nxënësve. Mësimdhënia bashkëkohore dikton përdorimin e metodave dhe të teknikave, të cilat synojnë jo thjesht dhënien e njohurive, por aftësimin e nxënësve për të përballuar sfidat e jetës e për të marrë pjesë suksesshëm në jetën personale dhe profesionale.

Mësuesit nga natyra janë krijues në procesin mësimor. Dashuria dhe pasioni për punën i bën ata të jenë vazhdimisht në kërkim të zhvillimit të tyre profesional. Mirëpo shpesh ndodh që megjithëse disa metoda dhe teknika, teksa i dëgjojnë në trajnime dhe seminare janë interesante, kur i zbatojnë në klasë hasin jo rrallë herë vështirësi. Për këtë arsye duhet që mësuesit të ndërgjegjësohen që: *Më e rëndësishme është ajo që mësohet dhe jo metoda që përdoret*. Pra, metodat dhe teknikat duhet të përshtaten me natyrën e lëndës dhe qëllimet e të nxënësve.

Më poshtë janë përshkruar disa strategji, metoda dhe teknika që ndikojnë në zhvillimin e kompetencave në lëndën e gjuhës shqipe.

9.1 Strategjitë e të lexuarit

Strategjitë e të lexuarit janë sjellje të matura që nxënësit duhet të përdorin për të kuptuar se çfarë lexojnë. Ata duhen mësuar të përdorin një larmi strategjish, por më të rëndësishmet janë: parashikimi, lidhja, përfytyrimi, identifikimi i ideve kryesore, përmbledhja, monitorimi dhe vlerësimi. Këto strategji mund të përdoren jo vetëm gjatë të lexuarit, por edhe gjatë të dëgjuarit dhe të shkruarit.

Në tabelën e mëposhtme është dhënë një përmbledhje e tetë strategjive.


Strategji	Çfarë bën lexuesi?	Si e ndihmon kjo strategji lexuesin?
Parashikimi	Nxënësit duhet parashikojnë rreth asaj që do të ndodhë në tekstin që lexojnë. Kur nxiten për të parashikuar, ata bëhen më kuriozë për atë që do të lexojnë. Parashikimet duhet të bazohen në njohuritë e tyre për temën, subjektin ose në informacionet që kanë lexuar më parë. Nxënësit mund të parashikojnë para leximit, por mund të parashikojnë edhe duke e lexuar tekstin pjesë-pjesë. Para leximit të çdo pjese, nxënësit parashikojnë rreth pjesës që vjen. Është e rëndësishme që mësuesi t'u kërkojë nxënësve argumentet rreth parashikimeve të tyre.	Lexuesi përcakton një qëllim dhe bëhet më i angazhuar gjatë leximit.
Lidhja	Nxënësit e personalizojnë leximin duke e lidhur jetën e tyre. Ata kujtojnë ngjarje të ngjashme, krahasojnë personazhin me veten ose njerëzit që njohin, ose lidhin tekstin me tekste të tjera që kanë lexuar më parë. Nxënësit mund të krahasojnë tekstin me vepra të tjera të	Lexuesi e personalizon të lexuarin nëpërmjet lidhjes së tekstit që lexon me njohuritë e tij të mëparshme.

	të njëjtin autor ose dy versione të të njëjtit subjekt (p.sh., dy përralla). Ata mund të bëjnë tri lloj lidhjesh: - tekstin me vetveten, - tekstin me botën, - tekstin me tekst.	
Përfytyrimi	Nxënësit përfytyrojnë rreth tekstit që lexojnë. Ata shpesh përfytyrojnë veten e tyre në imazhet që krijojnë rreth tekstit, përshtaten me personazhin e tekstit, udhëtojnë në kohën dhe në mjediset që përshkruhen, përjetojnë situatat konfliktuale së bashku me personazhet në tekst. Mësuesit mund t'u kërkojnë nxënësve që të mbyllin sytë dhe të imagjinojnë atë që kanë lexuar ose të vizatojnë skena ose personazhe që i përfytyrojnë. Aq futen në botën e librit nxënësit, sa nuk e pëlqejnë variantin film të një libri, pasi kur e kanë lexuar kanë krijuar "filmin" e tyre në mendje, i cili pa dyshim për ta është varianti më ideal. Përfytyrimet u zhvillojnë nxënësve imagjinatën dhe e kthejnë përvojën e tyre të leximit në kënaqësi.	Lexuesi përdor imazhet që të memorizojë dhe të kuptojë më mirë tekstin.
Monitorimi	Nxënësit pyesin rreth asaj që lexojnë dhe angazhohen më shumë me tekstin (bëhen më të vëmendshëm) që të gjejnë aty përgjigjet e tyre. Nxënësit, gjithashtu, pyesin që të sqarojnë moskuptimet. Tradicionalisht, mësuesit kanë drejtuar pyetje dhe nxënësit janë përgjigjur, por kur nxënësit bëjnë pyetje, e kuptojnë më mirë një tekst, se sa kur ata i pyet mësuesi. Shpesh nxënësit nuk dinë të drejtojnë pyetje, prandaj mësuesit duhet të ndërhyjnë në këtë aspekt. Ata duhet t'i mësojnë dhe t'i nxitin nxënësit të pyesin. Kur nxënësit zbulojnë ndonjë problem në të kuptuarit, atëherë pyesin mësuesin ose shokët e klasës, lexojnë më shumë rreth temës së tekstit, e rilexojnë tekstin etj.	Lexuesi monitoron të kuptuarit e tekstit. Lexuesi bën pyetje që të sqarohet dhe të kuptojë tekstin.
Identifikimi i ideve kryesore	Nxënësit analizojnë tekstin që të nxjerrin idetë kryesore, sepse është e pamundur të kujtojnë gjithçka. Nxënësit duhen mësuar që të diferencojnë idetë e rëndësishme nga të parëndësishmet. Shpesh, mësuesit i drejtojnë nxënësit drejt ideve	Lexuesi përqendrohet në idetë kryesore dhe nuk "humb" në detajet e parëndësishme.

	kryesore që në fillim të leximit, kur ata përcaktojnë para nxënësve qëllimet e të lexuarit. Nxënësit mund të përdorin organizuesit grafikë për të theksuar idetë kryesore.	
Përmbledhja	Nxënësit duhet të sintetizojnë idetë e rëndësishme që të bëjnë përmbledhje. Ata nisin nga përcaktimi i ideve kryesore, fshijnë detajet, lënë informacionin e rëndësishëm dhe pastaj bëjnë përmbledhjen. Njohja e strukturës së tekstit i ndihmon nxënësit që të dallojnë idetë e rëndësishme dhe të shohin se si janë lidhur. Nxënësit p.sh., ndajnë në një tregim fillimin, zhvillimin dhe fundin, përcaktojnë problemin dhe lexojnë për zhvillimin dhe zgjidhjen në fund të tregimit. Në një tekst jo letrar, ata shohin për krahasim-kontrastin, shkak-pasojën dhe struktura të tjera të tekstit dhe pastaj e përdorin strukturën për të dalluar idetë kryesore.	Lexuesi e ruan më mirë në kujtesë atë që lexon, kur bën përmbledhje.
Vlerësimi	Nxënësit duhet të reflektojnë mbi eksperiencën e tyre të leximit dhe të vlerësojnë tekstin. Ata mund ta bëjnë këtë duke u ndaluar në disa aspekte: - A e kanë pëlqyer tekstin? Pse? - Cilat janë opinionet e tyre rreth tekstit? - Cilat janë njohuritë që fituan nëpërmjet leximit? - A mund ta përdorin atë që mësuat? Përmes vlerësimit, nxënësit bëhen më të përgjegjshëm në procesin e të nxënës.	Lexuesi merr përgjegjësi.

9.2 Fazat e të shkruarit

Një nga kërkesat e programit të gjuhës shqipe për të shkruarit është që ka rëndësi jo vetëm produkti, por edhe procesi i të shkruarit. Nxënësit shpesh ndihen të mbingarkuar në punët me shkrim, pasi ata mendojnë vetëm produktin final. Do të ishte ndihmë për nxënësit që të orientohen të mos përqendrohen në produktin final, por të ndjekin disa hapa të vegjël. Këta hapa u krijojnë mundësi nxënësve që të mos e ndiejnë veten të mbingarkuar, të bëjnë punë cilësore dhe të mësohen të punojnë në mënyrë të pavarur.



Qëllimi dhe lexuesi

Para se të fillojnë të shkruajnë, nxënësit duhet të mendojnë për qëllimin dhe lexuesin e punës me shkrim (*Për çfarë do të shkruani? Cili është qëllimi? Kush është lexuesi i shkrimit tuaj?*). Në varësi të tyre ndryshon edhe stili i të shkruarit. Nxënësit kuptojnë se ndryshe i shkruhet një miku dhe ndryshe një të rrituri, ndryshe shkruhet një raport dhe ndryshe shkruhet një poezi.

Zhvillimi i ideve

Mësuesi i orienton nxënësit që fillimisht të vendosin për mesazhin që do të përcjellin në punën me shkrim. Zhvillimi i ideve fillon me një stuhi mendimi për çështjet që mund të trajtohen në punën me shkrim.


P.sh.: *Argumentoni pse i duam lojërat.*

Nxënësit thonë:

- argëtohemi;
- miqësohemi me njëri-tjetrin;
- mësohemi të zbatojmë rregullat;
- etj.

Një tjetër teknikë që mund të përdoret është kllasteri, i cili lejon të shtohen dhe të shprehen lirshëm mendimet rreth temës.

P.sh.: Nëse tema do të ishte “Rëndësia e leximit në jetën tonë”, nxënësit mund të shkruanin një kllaster të tillë.



Planifikimi

Kur puna me shkrim është e gjatë, është mirë që nxënësit të bëjnë një plan pune. Një plan i thjeshtë do të përfshinte:

- Shënime të ideve të punës me shkrim.
- Një listë burimesh informacioni.
- Një listë të fakteve që do të shkruhen.

Kopja e parë

Kjo është faza, kur nxënësit fillojnë të shprehin idetë e tyre. Kopja e parë nuk është e lehtë të realizohet, prandaj mësuesi mund t'i udhëzojë nxënësit, si p.sh.:

- Mos u shqetësoni që gjithçka të jetë e përkryer. Mund të bëhen edhe ndryshime më vonë.
- Shkruani në një anë të fletës për të lënë vend për ndryshimet.
- Mund të shtoni edhe ide të reja gjatë shkrimit të kopjes së parë.

Rishikimi, redaktimi dhe korrigjimi

Rishikimi i një pune me shkrim mund të bëhet nga vetë nxënësi ose nga një nxënës tjetër (shoku i bangës). Disa nga udhëzimet që mësuesi mund t'u japë nxënësve janë:

- Lexoni me zë.
- Bëni pyetje (*A është i kuptueshëm shkrimi?; A janë renditur idetë si duhet?; A ka përsëritje?etj.*).
- Lexoni përsëri.
- Rregulloni gabimet drejtshkrimore dhe shenjat e pikësimit.
- Shkruani variantin e përfunduar.

Redaktimi dhe korrigjimi janë për t'u siguruar që struktura, gjuha e zgjedhur, gramatika dhe drejtshkrimi janë të sakta.

Botimi ose dorëzimi

Pasi nxënësit kanë bërë korrigjimet e fundit, është koha e dorëzimit. Kjo kopje duhet të jetë gati për t'u lexuar. Nxënësit udhëzohen të shtojnë edhe elemente të tjera (sidomos kur puna shkruhet në kompjuter), si p.sh.: tabelë përmbajtjeje, tituj dhe lista, grafikë etj.

9.3 Metodat dhe teknikat mësimore që mund të përdoren në lëndën e gjuhës shqipe

Më poshtë janë dhënë disa metoda dhe teknika që mund të përdoren në lëndën e gjuhës shqipe.

Stuhi mendimi

Stuhia e mendimeve është një teknikë, e cila kërkon që nxënësit të tregojnë gjithçka që dinë rreth një teme ose ideje të veçantë, e cila nis t'u rikujtojë atyre njohuritë që kanë. Nxënësit nuk mendohen gjatë nëse idetë që u vijnë në mendje, janë të drejta ose të gabuara. Mësuesi i hedh të gjitha idetë në tabelë. Duke dëgjuar mendimet e të tjerëve, nxënësve mund t'u kujtohen gjëra të tjera ose mund t'u shtohet informacion i ri në kujtesën e tyre. Kjo teknikë përdoret, kur nxënësit kanë njohuri paraprake rreth një teme të caktuar. Është një veprimtari e mirë për fillimin e mësimit.

Shembuj:

- *Çfarë janë legjendat?*
- *Çfarë dini për Naim Frashërin?*
- *Çfarë janë përemrat?*
- *Çfarë kuptoni me fjalën "leksik"?*

Lexim i drejtuar

Kjo teknikë i nxit nxënësit të lexojnë dhe të parashikojnë rreth një teksti (*tregim, fragment, përrallë, fabul*). Mësimi nis me një diskutim rreth tekstit, si p.sh.: *Për çfarë mund të flasë përralla "Rinë Katerinëza"? Pse mendoni kështu?*. Në këtë fazë mësuesi pranon çdo parashikim të nxënësve. Më pas teksti lexohet pjesë-pjesë (*me ndihmën ose jo të mësuesit*) dhe pas çdo pjese, pasi rikujtohet çfarë ka ndodhur, nxënësit parashikojnë si do të vijojnë ngjarje, duke e mbështetur parashikimin e tyre në argumente.

Kjo teknikë i nxit nxënësit të lexojnë dhe mban gjallë kureshtjen e tyre, por nuk duhet harruar se ndalesat e shpeshta dhe të gjata mund ta cenojnë të kuptuarit e përmbajtjes.

Shembull: Tregimi "Mandolina"

Ndalesa e parë:

Mësuesi pyet nxënësit:

- Ku i kishin futur të hollat djemtë?
- Pse ata ishin të detyruar që të punonin që në moshë të re?
- Për cilën kohë flet tregimi?
- A bënë mirë prindërit që nuk ua morën paratë fëmijëve?
- Si e kuptoni shprehjen "*Mirësjellja na u shpërblye*"?
- Si mendoni se do t'i prishin paratë fëmijët?
- Çfarë parashikoni se do të ndodhë më tej?

- Ku e mbështesni këtë mendim?

Ndalesa e dytë:

Mësuesi pyet nxënësit:

- Çfarë bënë fëmijët me paratë?
- A ndodhi siç e kishit parashikuar ju?
- Cilat ishin dyqanet e tyre të preferuara? Pse?
- Cilat janë sipas mendimit tuaj gjërat dhe sendet më interesante që blenë fëmijët?
- Po të ishit ju në vend të tyre çfarë do të blinit?
- Çfarë ju bën përshtypje në çastin kur fëmijët panë mandolinën?
- Çfarë do të ndodhë më tej? Pse mendoni kështu? Ku e mbështesni?
- Etj.

Parashikim me terma paraprakë

Kjo metodë përdoret për të nxitur kuriozitetin e nxënësit për të lexuar, për të zhvilluar imagjinatën dhe për të kuptuar më mirë tekstin. Ajo e vendos nxënësin në rolin e një zbuluesi me një gjëagjezë, të cilën dëshiron ta zgjidhë. Mësuesi prezanton para nxënësve 4-5 terma të rëndësishëm rreth një teksti. Nxënësit, duke u bazuar në termat e dhënë, parashikojnë rreth brendisë ose subjektit të tekstit.

P.sh., për fragmentin “Muji dhe zanat”, mësuesi shkruan në tabelë termat: *kreshnik, zana, qumësht gjiri, fuqi*, ndërsa nxënësit bazuar në to, parashikojnë rreth brendisë së fragmentit.

Alfabeti i njëpasnjëshëm i tryezës së rrumbullakët

Kjo teknikë përdoret që nxënësit të kujtojnë terma, fakte ose ngjarje për një temë ose një grup temash mësimore, si dhe që të pasurojnë fjalorin. P.sh., në fazën e fundit të një ore mësimi, nxënësit e klasës së gjashtë që janë njohur dhe kanë punuar me disa poezi për atdheun, plotësojnë në grupe tabelën me fjalë që kanë lidhje me atdheun.

A Atdhe Atë Atdhetar	B Bukuri Begati Besim Besnikëri	C	Ç	D Dashuri Det Dëshirë	Dh Dhe Dhuratë Dhimbje
E Erë	Ë Ëmbëlsi Ëndërr	F Flamur Fitore Festë Frymëzim Frymë Fusha	G Gëzim Gur	Gj Gjuhë	H

I	J	K	L	Li	M
N	Nj	O	P	Q	Rr
Rr	S	Sh	T	Th	U
V	X	Xh	Y	Z	Zh

Lojë me role

Nëpërmjet kësaj teknike nxënësit interpretojnë ose lexojnë me role një tekst ose një fragment. Nxënësit ndajnë rolet mes tyre (*ose me ndihmën e mësuesit*), dhe më tej lexojnë ose interpretojnë bukur pjesën e përzgjedhur.

Për këtë teknikë janë të preferueshme tekstet dramatike, megjithatë nxënësit mund të kthejnë edhe një tekst rrëfyes në tekst dramatik, si dhe mund të improvizojnë një situatë të caktuar. Loja me role mund të zbatohet jo vetëm gjatë orëve të të lexuarit, por edhe gjatë orëve të gramatikës, si p.sh.: *nxënësit improvizojnë me role në një situatë, ku prezantohen duke folur në gjuhë standarde dhe në dialekt.*

Përparësitë e kësaj teknike janë:

- Krijon mundësi për punë në grup dhe ndërveprim mes nxënësve.
- Zhvillon tek nxënësit ndjenjën e empatisë.
- Ndikon në zhvillimin emocional të nxënësve.

Analiza e tipareve semantike

Kjo metodë i drejton nxënësit në analizën e termave ose të koncepteve duke përcaktuar karakteristikat kryesore të këtyre koncepteve dhe duke i krahasuar këto karakteristika me koncepte të tjera të njohura.

Përdorimi i kësaj metode u krijon mundësinë nxënësve që:

- të ndërtojnë në mënyrë të qëndrueshme njohuritë e reja;
- të analizojnë koncepte të ndryshme;
- të dallojnë ngjashmëritë dhe dallimet mes koncepteve;
- të bëjnë një përmbledhje në përfundim të një kapitulli ose grupi orësh;
- etj.


P.sh.: Tabela e mëposhtme ka klasat e ndryshueshme të fjalëve dhe kategoritë e tyre gramatikore. Nxënësit shënojnë +, kur klasa e fjalëve e ka atë kategori gramatikore, dhe – kur klasa e fjalëve nuk e ka atë kategori gramatikore.

Kategoria gramatikore/ klasat e fjalëve	Gjinia	Trajta	Numri	Rasa	Lakimi	Shkalla	Mënyra	Koha	...
Emri	+	+	+	+	+	-	-	-	-
Mbiemri	+	-	+	+	-	+	-	-	-
Përemri	+	-	+	+	-	-	-	-	-
Folja	-	-	+	-	-	-	+	+	-
Ndajfolja									
...									

Harta e tregimit

Brenda kutizave plotësohet titulli i pjesës dhe shkurtimisht shkruhet hyrja, zhvillimi dhe mbyllja e tregimit, përrallës, historisë etj. Kjo teknikë i ndihmon nxënësit që të kuptojnë strukturën e një teksti dhe të analizojnë atë.

Shembulli i mëposhtëm është për përrallën “Gërzheta”.



Rrjeti i diskutimit

Rrjeti i diskutimit është një teknikë që ndërtohet mbi bazën e një pyetjeje të hapur që pranon si përgjigje pozitive, ashtu edhe përgjigje negative. Kjo pyetje prek direkt thelbin e temës ose të çështjes. Mësuesi shkruan në tabelë pyetjen sipas organizuesit grafik të mëposhtëm dhe u kërkon nxënësve që për 5 minuta të shkruajnë pa pushim argumente nën të dyja përgjigjet. Kur t'i përfundojnë ato, nxënësit do të vendosin të mbajnë një qëndrim të caktuar dhe të binden për të. Përdorimi i kësaj teknike zhvillon të nxënësit aftësitë e të menduarit në mënyrë kritike dhe krijuese.

Shembull:

Po	<i>A duhet të bënin fëmijët sakrificën për ta blerë mandolinën? Pse?</i>	Jo
-----------	--	-----------


Kllasteri

Kjo teknikë përdoret për të grupuar ide, mendime, tipare, koncepte etj. Ajo i nxit nxënësit të mendojnë lirshëm për probleme ose koncepte të caktuara. Hapat për zbatimin e teknikës janë këta:

- Shkruhet një fjalë në qendër të një flete ose në tabelë. Bëhet një pyetje rreth saj. P.sh., shkruhet në qendër fjala “Prozë poetike” dhe bëhet pyetja “*Cilat janë tiparet e prozës poetike?*”
- Nxënësit shkruajnë fjalët ose frazat rreth pyetjes së bërë.

Teknika i ndihmon nxënësit që të analizojnë një koncept, një term, një fjalë etj.


Më poshtë është dhënë kllasteri për personazhin e Vilhelm Telit.



Diagrami i Venit

Diagrami i Venit është një teknikë me anë të së cilës evidentohen të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet dy koncepteve, dukurive etj. Ai ndërtohet mbi dy ose më shumë rrathë të mbivendosur, me një hapësirë në mes. Në pjesën që pritet shkruhen të përbashkëtat dhe në pjesët e tjera shkruhen dallimet.

Shembull: Krahasimi i dy teksteve që trajtojnë të njëjtën tematikë.



Harta e konceptit

Kjo metodë ndihmon në pasurimin e të kuptuarit të një fjale ose të një koncepti nga nxënësit. Hartat e konceptit janë struktura grafike që përqendrojnë vëmendjen e nxënësve në përbërësit kryesorë të një përkufizimi: klasa apo kategoria, cilësitë apo karakteristika, ilustrimet dhe shembujt.

Më poshtë është dhënë një hartë koncepti për dramën (*Çfarë është? Cilat janë karakteristikat e dramës? Shkruani disa shembuj dramash.*).



INSERT (Interactive Notice System for Effective Reading and Thinking).

Kjo teknikë zbatohet si më poshtë.

Mësuesi u jep nxënësve një tekst për të lexuar. Gjatë leximit të këtij teksti, nxënësit vendosin shenjën:

- një √, kur informacioni është i njohur;
- një +, kur informacioni është i ri;
- një –, kur informacioni është i kundërt me atë, që di ;
- një ?, kur informacioni është i paqartë dhe nxënësi kërkon të dhëna shtesë.

Pas leximit nxënësit diskutojnë me njëri-tjetrin rreth shënimeve të tyre. Më pas, mund të sqarojnë me mësuesin idetë e paqarta.

Përparësitë e kësaj teknike

- Lejon nxënësit të kontrollojnë gjerësisht shkallën e tyre të të kuptuarit gjatë leximit.
- Aftësohen nxënësit të punojnë në mënyrë të pavarur.

Në lëndën e gjuhës shqipe, INSERT mund të përdoret në tema mësimore për të cilat nxënësit kanë njohuri paraprake rreth saj, si p.sh., në temën “Llojet e sinonimeve dhe antonimet”.

Di /dua të di/mësova më shumë

Një formë e ngjashme e teknikës INSERT është teknika “Di/ dua të di/ mësova më shumë”, skema e të cilës është kjo:

Di	Dua të di	Mësova

Në kolonën e parë, “Di”, nxënësit do të shkruajnë atë informacion që për ta është i njohur. Në kolonën e dytë, “Dua të di”, do të shkruhen pyetje ose kërkesa të nxënësve, rreth çështjeve për të cilat ata kërkojnë të dinë më tepër. Pasi nxënësit lexojnë tekstin, plotësojnë kolonën e tretë “Mësova”.

Në kolonën e tretë, “Mësova”, nxënësit do të shkruajnë një përmbledhje të informacionit të ri që përvetësovan nga teksti.

Shembull: Mbiemri e emëruar.

Di	Dua të di	Mësova
- Mbiemri është pjesë e ndryshueshme e ligjëratës që tregon tipar. - Ka kategorinë e gjinisë, numrit dhe rasës, si dhe përshtatet me emrin që përcakton. - Mund të jetë i nyjshëm ose panyjshëm.	- Cilës klasë i përket mbiemri i emëruar, emrit apo mbiemrit? - Ku dallon nga secila prej klasave? - Çfarë kategorish gramatikore ka dhe nga varet?	- Mbiemri i emëruar i përket klasës së emrave. - Nuk emërton thjesht tiparin, por vetë sendin a frymorin së bashku me tiparin. - Është i mëvetësishëm si emri dhe ka kategoritë gramatikore të tij. - Nuk merr parashtesa dhe prapashtesa kur kalon në kategorinë e emrit.

Skeda e personazhit

Skeda e personazhit është analiza që nxënësit realizojnë për personazhet e teksteve letrare (poetike, në prozë ose dramatike). Nxënësit lexojnë tekstin ose fragmentin dhe plotësojnë skedat. Më pas ato i shkëmbejnë me njëri-tjetrin (ndonjëherë edhe me ndihmën e mësuesit). Përgjigjet mund t'i shënojnë në një tabelë përmbledhëse. Përparësitë e kësaj teknike janë:

- Aftëson nxënësit që të lexojnë në mënyrë kritike.
- Aftëson nxënësit të analizojnë personazhet;
- Nxit punën në grupe.

Në varësi të personazhit, shtohen, pakësohen ose ndryshohen kolonat. P.sh., mund të shtohet një kolonë për tiparet fizike, një kolonë për cilësitë e karakterit etj. Në mënyrë tabelare kjo teknikë paraqitet si më poshtë.

Skeda e personazhit			
<i>Çfarë ndjen?</i>	<i>Shembuj dhe ilustrime</i>	<i>Si vepron?</i>	<i>Shembuj dhe ilustrime</i>
Gëzim	<i>Nuk e dinte përse ishte gëzuar, aq shumë... Gëzimi po i fashitej dalëngadalë. Ai ndjente një gëzim që nuk e kishte provuar deri tani. Kur u përmend ndjeu se po qante etj., etj.</i>	Futet në det	<i>Djali i zhvesh dhe u fut në det.</i>
Panik	<i>Djalin e pushtoi përsëri paniku... Iu shfaq i dobët paniku. Paniku, ashtu si herën e parë, i filloi në bark dhe zuri t'i përhapej në të gjithë trupin.</i>	Vendos të notojë	<i>Do të notoj deri sa të lodhem etj.</i>

Ditari dypjesësh

U jepet nxënësve pjesa për lexim. U thuhet atyre që të bëjnë nënvizime në pjesët që ju bëjnë përshtypje, që ju pëlqejnë, që duan të thonë diçka, apo për të cilat kanë pyetje. Pas leximit dhe nxjerrjes së citimeve ose pjesëve që u pëlqejnë, u jepet kohë nxënësve të bëjnë komentet e tyre,

sipas modelit më poshtë. Nëpërmjet kësaj teknike, nxënësit aftësohen të mendojnë në mënyrë kritike rreth tekstit që lexojnë.

Vargjet që ju pëlqejnë më shumë	Komenti
Këtë gur ta hedhësh më lart se unë. Kurrë mos mendo se i pari jam unë.	Guri është përpjekja dhe arritjet që realizon njeriu në jetë. Poeti e këshillon të birin që t'i tejkalojë arritjet e të atit. Njeriu nuk duhet të vuajë nga vetëkënaqësia dhe mbivlerësimi për veten.

Pesëvargëshi

Është një poemë me pesë vargje dhe pa rimë. Përdoret si mjet për të inkurajuar nxënësit të reflektojnë mbi një tekst. Vargjet kanë këtë përbërje:

- Titulli që është zakonisht një emër.
- Përshkrimi që përbëhet nga dy mbiemra.
- Veprimi që përbëhet nga tri folje.
- Ndjenja që është një fjali me katër fjalë.
- Përcaktimi i thelbit që është një emër sinonim me titullin.

Shembull: Fragment nga romani “Kështjella” i Ismail Kadaresë.

- Kështjella.
- E pamposhtur, e gurtë.
- Qëndronte, mbrohej, gumëzhinte.
- Kështjella e ka tmerruar ushtrinë armike.
- Kalaja.

Kubimi

Kubimi është një teknikë që përfshin të gjitha nivelet e të mësuarit dhe mundëson përvetësimin e koncepteve nga të kuptuarit deri te argumentimi. Kjo teknikë mund të punohet në grupe, kryesisht në fazën e demonstrimit të rezultateve të arritura. Në çdo faqe të kubit shënohet një nga pyetje dhe nxënësit punojnë me konceptin duke iu përmbajtur pyetjes ose kërkesës në faqen e kubit.

- *Përshkruaj:* Format, shenjat, përmasat, ngjyrat.
- *Krahaso:* Më kë ngjason? Nga se ndryshon?

- *Shoqëro*: Çfarë ju vjen në mendje?
- *Analizo*: Si është ndërtuar? Nga se përbëhet?
- *Zbato*: Ç'mund të bëni me të? Si mund të përdoret?
- *Argumento*: Merr një qëndrim, pro ose kundër tij.

Shembull: Fragment nga “Odisea”.

- *Përshkruaj*: Cilësitë fizike e cilësitë morale të Odisesë duke u bazuar në fragment.
- *Krahaso*: Me bashkëluftëtarë të tjerë në vepër, me të birin, me heronj të tjerë të Homerit etj.
- *Shoqëro*: Me figurën e Skëndërbeut kur kthehet në atdhe, me Ymer Agën etj.
- *Analizo*: Sjelljet e tij gjatë peripecive rrugës për në atdhe, si në ishullin e Circias.
- *Zbato*: Ç'mesazhe e vlera përcjell figura e tij?
- *Argumento*: Jeni dakord me hakmarrjen ndaj gjithë armiqve të tij gjatë festës, kur kthehet në shtëpi.

Diktimi

Diktimi është një teknikë që përdoret për zhvillimin e aftësive drejtshkrimore dhe të pikësimit. Mësuesi mund të planifikojë dhe mund të realizojë dikttime në orë të veçanta ose në një pjesë të orëve të drejtshkrimit, të shenjave të pikësimit ose të gramatikës (p.sh., përshtatja e foljes me kryefjalën, rendi i fjalëve në fjali etj.).

Nisur nga qëllimet për të cilat zhvillohen dhe nga rrugët, mënyrat e format didaktike që përdor mësuesi, diktimet mund t'i klasifikojmë si më poshtë:

Diktim me kopjim: Nxënësit i jepet një tekst, ku mungojnë fjalë e grupe fjalësh që lidhen me një çështje drejtshkrimore apo pikësimi. Nxënësi, gjatë kopjimit mund t'i plotësojë vendet bosh, ose pret leximin (edhe për qëllime drejtshqiptimi e intonacioni) nga mësuesi dhe pastaj shkruan tekstin.

Diktim me paralajmërim: Një nga format e këtij diktimi është rasti kur nxënësve u bëhet i njohur teksti që do të shkruhet gjatë orës së diktimit, në mënyrë që ata ta lexojnë paraprakisht dhe ta njohin tekstin. Një formë tjetër e diktimit me paralajmërim është përsëritja dhe përforcimi i rregullave drejtshkrimore dhe i atyre të pikësimit, nga nxënësit bashkë me mësuesin, para zhvillimit të diktimit, gjatë të cilit nxënësit do të shkruajnë një tekst ku kërkohet zbatimi praktik i rregullave drejtshkrimore të trajtuara.

Vetëdiktim: Nxënësit mësojnë pjesë përmendsh, në poezi ose në prozë. Një nga këto pjesë mund të shërbejë për diktim. Mësuesi duhet të përzgjedhë për diktim pjesë ku gjejnë përdorim rregulla

drejtshkrimore e rregulla të pikësimit. Para se nxënësit të shkruajnë diktimin, porositen që ta lexojnë me vëmendje pjesën e mësuar përmendsh, në mënyrë që ata të krijojnë një njohje më të mirë të formës gjuhësore të tekstit.

Sugjerohet që teksti që do të përdoret për diktim, afërsisht të përmbajë:

- në klasën V , rreth 100 fjalë;
- në klasën VI , rreth 120 fjalë;
- në klasën VII, rreth 150 fjalë;
- në klasën VIII, rreth 180 fjalë;
- në klasën IX, rreth 200 fjalë.

Kriteret e vlerësimit duhet t'u përgjigjen pyetjeve, të tilla si: *Sa i saktë është nxënësi? Cila është rëndësia e rregullës drejtshkrimore që nuk e zbaton nxënësi? Si shkruan nxënësi? Pse ka gabuar ai? Cilat janë llojet e gabimeve që bën?* etj.

Tri mënyra të kontrollit dhe të vlerësimit të diktimit

- Pasi mbaron diktimi, nxënësit ballafaqojnë në çift punën e njëri-tjetrit, diskutojnë për saktësinë dhe bëjnë ndërhyrjet e nevojshme për përmirësim, duke kërkuar edhe ndihmën e mësuesit, nëse takojnë raste për të cilat nuk arrijnë të japin zgjidhjen e duhur. Probleme të veçanta diskutohen me gjithë klasën. Në këtë rast, nuk është e nevojshme të mbledhen fletoret për t'u qortuar dhe për t'u vlerësuar me notë.
- Pasi mbaron diktimi, mësuesi e pajis çdo nxënës me tekstin e saktë. Nxënësi vetëqorton dhe vetëvlerëson punën e tij. Mësuesi merr informacion për rastet ku nxënësit kanë gabuar më shumë. Edhe në këtë rast nuk është e nevojshme të mbledhen fletoret për t'u qortuar, pasi gabimet më tipike diskutohen e sqarohen me të gjithë nxënësit. Mësuesi duhet të informohet mirë për rezultatet e çdo nxënësi, pasi ai duhet të mbledhë e të grupojë, sipas dukurive, mangësitë e nxënësve, sepse kështu do të dijë ku ta përqendrojë punën e tij në ditët e javët në vazhdim.
- Mësuesi mbledh fletoret, i kontrollon ato një për një pas mësimit dhe i vlerëson me notë, duke e shoqëruar atë me shënime për nxënësin. Orën tjetër të mësimit, mësuesi paraqet para nxënësve në klasë përfundimet që ka nxjerrë, duke u fokusuar në gabimet më të shpeshta të të gjithë klasës, por edhe në gabime tipike të bëra nga nxënës të veçantë. Në varësi të kohës për diskutim, mësuesi mund të paraqesë para klasës formën e pasaktë dhe kërkon që nxënësit të japin gjykimin e tyre. Ose paraqet para gjithë klasës formën e saktë dhe u lë nxënësve kohë

të mjaftueshme të sjellin në kujtesë saktësinë e tyre në diktimin e kaluar. Në këtë formë, nxënësit bëjnë, në mënyrë “të padukshme”, vetëqortim dhe qortim të ndërsjellë.

Projekti kurrikular

Projekti kurrikular në lëndën e gjuhës shqipe është rubrikë e detyruar e portofolit të të nxënës. Ai është strategji e të nxënës dhe e mësimdhënies me në qendër nxënësin përmes së cilës nxënësit në mënyrë individuale ose si një anëtar i një grupi hulumtojnë mbi një çështje të caktuar ose një problem të lidhur me jetën reale. Projekti si veprimtari integruese me karakter kërkimor e krijues nxit zhvillimin e aftësive të larta të të menduarit, aftësive komunikuese, të bashkëpunimit, të përdorimit të TIK, të sipërmarrjes etj.

Zbatimi i një projekti në lëndën e gjuhës shqipe kërkon jo më pak se tri orë mësimore. Projekti kurrikular mund të jetë i shtrirë përgjatë gjithë vitit shkollor, pra në të tria periudhat, por mund të jetë i shtrirë dhe vetëm brenda një periudhe. Sido që të jetë shtrirja e projektit, ai ka vlerësimin e tij brenda vlerësimit të portofolit të çdo periudhe. Mësuesi që kur planifikon projektin duhet të ketë në mendje vlerësimin e tij. Vlerësimi nuk është diçka që ndodh vetëm në fund të projektit, mësuesi vlerëson nxënësit dhe përgjatë zhvillimit të tij. ***Nëse projekti ka shtrirje përgjatë gjithë vitit, në çdo periudhë vlerësohet si pjesë e portofolit ajo pjesë e projektit që është realizuar. Në rastin kur ka shtrirje brenda një periudhe vlerësohet i gjithë projekti.***

Planifikimi dhe zbatimi në mënyrë efikase i një projekti kërkon që mësuesi të përcaktojë qartë detyrën mësimore në detaje për çdo grup dhe nxënë (është mjaft e rëndësishme që secili nxënë të jetë i përfshirë dhe i angazhuar me detyra të përcaktuara); të paraqesë rezultatet e të nxënës që do të arrihen nëpërmjet projektit; të paraqesë hollësisht çdo fazë të realizimit të projektit; të qartësojë nxënësit për arritjen përfundimtare të projektit; të qartësojë nxënësit për kriteret e vlerësimit të projektit; të vëzhgojë dhe të japë gjykimin e tij në mënyrë të vazhdueshme përcurinë e zbatimit të projektit. Për realizimin e projektit shfrytëzohen përvojat vetjake të nxënësve dhe njohuritë e marra nga burime të ndryshme.

Realizimi i një projekti në lëndën e gjuhës shqipe kërkon përdorimin e më shumë se një metode dhe teknike, si: vrojtimi, studimi i rastit, puna me skeda, intervista, puna në grup, puna individuale etj.

Hapat kryesorë që ndiqen për realizimin e një projekti janë:

- Përcaktohet saktë çështja ose problemi për të cilin do të hulumtohet, në mënyrë që të jetë i menaxhueshëm në kohë.

- Përcaktohen detyrat që duhet të realizohen për të grumbulluar të dhënat e nevojshme nga puna e secilit nxënës.
- Grumbullohet materiali dhe/ose mjetet e nevojshme.
- Përpunohen dhe analizohen të dhënat e grumbulluara.
- Nxirren përfundime dhe përgjithësime nga të dhënat e grumbulluara dhe përgatitet produkti përfundimtar.
- Prezantohen gjetjet dhe përfundimet e projektit ose prezantohet produkti i krijuar.

Për planifikimin e një projekti mësuesi ndërton planin e projektit, rubrikat kryesore të të cilit paraqiten më poshtë. Në varësi të tematikës së projektit dhe specifikave të tij mësuesi mund të pasurojë planin me rubrika të tjera. Mësuesi planifikon në planin e tij ditë orë të planifikuara të projektit sikurse vepron me orët e tjera mësimore.

Rubrikat kryesore të planit të një projekti kurrikular janë si më poshtë:

- **Tema e projektit:** Tema përcaktohet nga mësuesi në bashkëpunim me nxënësit. Tema duhet të ketë lidhje me lëndën dhe qëllimet e saj.
- **Kohëzgjatja e projektit/orët mësimore:** Përcaktohet sasia e orëve të projektit. Nëse projekti është ndër-lëndor, përcaktohet kontributi i çdo mësuesi dhe orët mësimore për secilën lëndë.
- **Klasa/t pjesëmarrëse:** Përcaktohet klasa ose klasat, në rast se ka disa.
- **Rezultatet e të nxënit:** Përfshijnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që do të zhvillohen përmes veprimtarive të projektit.
- **Konceptet kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit:** Përcaktohen konceptet që duhet të zotërojë nxënësi për realizimin e këtij projekti.
- **Partnerët:** Përcaktohen partnerët nëse ka. P.sh., nëse projekti në lëndën e gjuhës shqipe ka si qëllim që nxënësit të hulumtojnë për fjalët e urta ose për shprehjet frazeologjike në zonën ku banojnë, një njohës i dialektit ose i të folmes së zonës mund të konsiderohet një partner pjesëmarrës në projekt.
- **Veprimtaritë kryesore që do të kryen për realizimin e projektit, afatet dhe personat përgjegjës.**
- **Burimet kryesore të informacionit:** Mësuesi duhet të orientojë nxënësit drejt përdorimit të burimeve të larmishme dhe të duhura të informacionit.
- **Tematika e orëve të planifikuara të planit mësimor:** Këtu vendoset tematika për çdo orë mësimore të projektit. P.sh., nëse projekti planifikohet në 6 orë, atëherë duhet vendosur tematika për të gjashta orët.

- **Përshkrimi i produktit të projektit:** Kjo rubrikë duhet të përfshijë shkurtimisht llojin e produktit që pritët të realizohet dhe mënyrën e prezantimit të tij.
- **Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi:** Mësuesi përcakton kritere për vlerësimin e projektit, të cilat ua komunikon nxënësve që në fillim të projektit. P.sh., kriteret mund të përcaktohen në lidhje me trajtimin e përmbajtjes në përmbushje të tematikës, përdorimin e burimeve të informacionit, përgatitjen e produktit, prezantimin e tij etj., në varësi të rezultateve të të nxënësve.

Shembuj kriteresh për vlerësimin e projektit:

A është fokusuar përmbajtja e projektit te çështja/problemi i identifikuar për shqyrtim?
A është lidhur tema e projektit me situata nga jeta reale?
A i kanë zbatuar nxënësit konceptet e marra në lëndën përkatëse?
A kanë mbledhur të dhëna bazuar në burime të mjaftueshme informacioni?
A kanë bashkëpunuar nxënësit për të zhvilluar aftësitë komunikuese, vetëmenaxhuese dhe organizuese?
Etj.

Sigurimi i të dhënave nga burime të ndryshme vlerësimi është thelbësorë për të nxënësin bazuar në projekte. Përfshirja e nxënësve në vlerësimin e projektit nxit motivimin dhe përmirëson të nxënësin e drejtuar prej tyre. Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i nxënësve nga njëri-tjetri nxit nxënësin të reflektojnë mbi pikat e tyre të dobëta dhe të forta, në mënyrë që të fokusojnë përpjekjet e tyre të mëtejshme.

Më poshtë përshkruhet modeli i një projekti kurrikular me shtrirje gjithë vjetore, për lëndën e gjuhës shqipe për klasën IX.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi

Lënda: Gjuhë shqipe

Shkalla: IV

Klasa: IX

Tema e projektit: Libër kujtimesh për shkollën 9- vjeçare (projekt i shtrirë gjatë gjithë vitit)

Rezultatet e të nxënësit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:

(Ora I dhe II do të zhvillohen në periudhën shtator- dhjetor)

Ora I

Nxënësi:

- analizon rëndësinë që ka një libër kujtimesh në përfundim të shkollës 9- vjeçare;
- argumenton se çfarë rubrikash mund të përfshihen në një libër kujtimesh;

- përcakton kontributin që mund të japë në hartimin e një libri kujtimesh.

Ora II

Nxënësi:

- hulumton dhe analizon modele të ndryshme të një libri kujtimesh;
- liston llojet e materialeve (teksteve) që mund të ketë një libër kujtimesh;
- përcakton strukturën që do të ketë prezantimi i çdo nxënësi në librin e kujtimeve;
- harton pyetje për intervista të ndryshme për mësues, staf drejtues dhe/ose prindër;
- përcakton faqosjen, fotot dhe ilustrimet e përbashkëta në një libër kujtimesh.

Ora III

(Ora III dhe IV do të zhvillohen në periudhën e dytë, janar-mars)

Nxënësi:

- shkruan hyrjen e një libri me kujtime;
- shkruan intervista të ndryshme;
- vlerëson punët e tij dhe të shokëve të klasës.

Ora IV

Nxënësi:

- shkruan një jetëshkrim të shkurtër personal;
- rrëfen ngjarje nga jeta e tij;
- shkruan tekste të ndryshme përshkruese duke respektuar strukturën e tyre.

Orët V- VI (nëse klasa pak nxënës, projekti realizohet në 5 orë)

(Orët V- VI do të zhvillohen në periudhën prill-maj. Do të bëhet prezantimi i librit.)

Nxënësi:

- sintetizon dhe përmbledh tekste rrëfyese, përshkruese etj. (për librin e kujtimeve);
- redakton shkrime të ndryshme;
- prezanton me një gjuhë të qartë punën e tij, duke përdorur edhe TIK-un.
- vlerëson punimet e shokëve të klasës, si dhe vetëvlerëson punimet e tij.

Njohuritë dhe aftësitë kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit

- Përshkrimi i mbresave gjatë nëntë viteve të shkollës për t'i ndarë me shokët dhe shoqet, me mësuesit dhe me prindërit.
- Shkrimi i rrëfimeve personale duke përshkruar ose reflektuar mbi veten, mbi përvojat personale, ngjarjet e kaluara ose çështje personale.
- Shkrimi i CV-je.
- Shkrimi i një interviste.

Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi, Teknologjia dhe TIK-u.

Numri i orëve që do të shfrytëzohen për realizimin e projektit: 5- 6 orë

Numri i nxënësve në projekt: Të gjithë nxënësit e klasës.

Përshkrim i projektit dhe i veprimtarive që do të zhvillohen në të.

- Prezantohet tematika, qëllimet, rezultatet e të nxënit, veprimtaritë kryesore të projektit, si dhe produkti përfundimtar i tij.
- Ndahen grupet e punës dhe përcaktohen detyrat kryesore për çdo grup.

- Hulumtohen dhe studiohen modele të librave të kujtimeve (hulumtime në internet, botime etj.)
- Përcaktohet struktura që ka një libër kujtimesh, si dhe listohen llojet e materialeve (shkrimeve) që përfshihen në të.
- Realizohen intervista të shkurtra ose mblidhen mbresa me stafin drejtues të shkollës, mësuesin kujdestar dhe mësuesit e klasës.
- Përzgjidhen fotot që do të përfshihen në librin e kujtimeve.
- Përcaktohet struktura e prezantimit të çdo nxënësi në librin e kujtimeve (foto, CV e shkurtër, kujtimi më i bukur, miku më i veçantë, mësuesi i dashur etj.).
- Analizohen dhe vlerësohen materialet që do të përfshihen në libër.
- Realizohet dizajni i kopertinës, faqosja e materialeve në librin e kujtimeve.

Ora I

Gjatë orës së parë diskutohet për rëndësinë që ka një libër kujtimesh, si dhe çfarë mund të përfshihet në të. Prezantohen tematika, qëllimet, rezultatet e të nxënit, veprimtaritë kryesore të projektit, si dhe produkti përfundimtar i tij. Ndahen grupet e punës dhe përcaktohen detyrat kryesore për çdo grup. Nxënësit shprehen për kontributin që mund të japin në hartimin e librit të kujtimeve.

Mësuesi udhëzon nxënësit për detyrat e orës së ardhshme:

- Grupi 1: hulumton strukturat, llojet e shkrimeve që kanë librat e kujtimeve dhe përcakton strukturën që do të ketë libri.
- Grupi 2: hulumton se si prezantohet çdo nxënës i klasës në libër dhe përcakton strukturën e prezantimit të çdo nxënësi.
- Grupi 3: hulumton se çfarë materialesh të tjera mund të përfshihen në libër dhe harton pyetjet për intervistat që do të realizohen me stafin drejtues, mësues ose prindër.
- Grupi 4: hulumton faqosjet dhe fotot e një libri kujtimesh dhe përzgjedh fotot e përbashkëta që do të përfshihen në librin e kujtimeve.

Ora II

Nxënësit (çdo grup) sjellin materialet e përcaktuara gjatë orës së parë. Grupet vlerësohen për to. Përcaktohen detyrat për orën e ardhshme dhe udhëzohen nxënësit për to.

- Grupi 1: Shkruan hyrjen e librit të kujtimeve.
- Grupi 2: Shkruan intervistat me stafin drejtues të shkollës.
- Grupi 3: Shkruan intervistat me mësuesit e klasës.
- Grupi 4: Shkruan intervistën me mësuesin kujdestar (mbresa, opinione etj.)

Ora III

Nxënësit (çdo grup) sjellin materialet e përcaktuara gjatë orës së dytë. Nxënësit diskutojnë rreth tyre dhe plotësojnë detyrat e njëri-tjetrit. Grupet vlerësohen për punën e kryer.

Përcaktohen detyrat për orën e ardhshme dhe udhëzohen nxënësit për to. Çdo nxënës do të ketë një ose dy faqe të tijat në libër në të cilin do të ketë:

- Foto të spikatura në shkolla 9- vjeçare.
- Një jetëshkrim i shkurtër personal.
- Rrëfime kujtimesh te rubrika “Kujtimi më mbresëlënës”.

- Përshkrim të rubrika “Shoku/shoqja më i/e veçantë”.
- Përshkrim të rubrika “Mësuesi më i dashur”.

Për orën IV përgatitet një draft i parë i pikave të mësipërme.

Ora IV

Nxënësit (çdo grup) sjellin materialet e përcaktuara gjatë orës së tretë. Nxënësit vlerësohen për to. Orën IV, nxënësit japin një ide përfundimtare mbi mënyrën e vendosjes së materialeve, dizajnit, fotove dhe hapësirës që do kenë nxënësit në librin e kujtimeve. Përcaktohen detyrat për orën e ardhshme dhe udhëzohen nxënësit për to.

- Grupi 1, 2 dhe 3: Redaktimi i librit të kujtimeve.
- Grupi 4: Faqosja e librit.
- Çdo nxënës sintetizon materialet e përgatitura për orën e katërt dhe prezanton në power point faqen/ et e tij.

Orët V- VI (nëse klasa ka pak nxënës, projekti mund të realizohet në 5 orë)

Gjatë orës së pestë prezantojnë në fillim dy grupet. Më pas çdo nxënës prezanton faqen/et e tij, me anë të një prezantimi në power point. Nxënësit diskutojnë dhe vlerësojnë punët e njëri- tjetrit.

Përshkrim i produktit të projektit: Produkti përfundimtar është një libër kujtimesh. Secili nxënës prezanton materialin personal në një minutazh të caktuar me projektor.

Vlerësimi

Shënim: *Çdo periudhë vlerësohet si pjesë e portofolit ajo pjesë e projektit që është realizuar. Ky projekt për të tria periudhat do të vlerësohet me 40 pikë.*

- Periudha e parë- 10 pikë
- Periudha e dytë- 15 pikë
- Periudha e tretë- 15 pikë

Në **periudhën e parë** nxënësit (sipas detyrave të grupit) do të vlerësohen si më poshtë.

Niveli 2

Nxënësi:

- përshkruan rëndësinë që ka një libër kujtimesh;
- liston 1-2 rubrika që mund të përfshihen në një libër kujtimesh;
- harton disa pyetje të thjeshta për një intervistë.

Niveli 3

Nxënësi:

- analizon rëndësinë që ka një libër kujtimesh;
- analizon modele të ndryshme të një libri kujtimesh;
- përcakton kontributin që mund të japë në hartimin e një libri kujtimesh;
- harton një intervistë të thjeshtë për mësuesit ose drejtuesit e shkollës.

Niveli 4

Nxënësi:

- argumenton rëndësinë që ka një libër kujtimesh;
- hulumton dhe analizon modele të ndryshme të një libri kujtimesh;

- përcakton strukturën që do të ketë libri i kujtimeve;
- argumenton kontributin që mund të japë në hartimin e një libri kujtimesh.
- harton një intervistë me pyetje të qarta dhe të sakta për mësuesit ose drejtuesit e shkollës.

Vlerësimi me pikë sipas niveleve është dhënë në tabelën e mëposhtme.

Niveli	Pikë
Niveli I (0%- 24%)	0- 2 pikë
Niveli II (25%- 50%)	3- 5 pikë
Niveli III (60%- 80%)	6- 8 pikë
Niveli IV (90%- 100%)	9-10 pikë

Në periudhën e dytë nxënësit (sipas detyrave të grupit) do të vlerësohen si më poshtë.

Niveli 2

Nxënësi:

- shkruan me një gjuhë të thjeshtë një jetëshkrim të shkurtër personal;
- rrëfen shkurtimisht një ngjarje nga jeta e tij;
- shkruan një tekst të thjeshtë e të shkurtër përshkrues.

Niveli 3

Nxënësi:

- shkruan me gjuhë të thjeshtë hyrjen e një libri me kujtime;
- realizon dhe shkruan intervista të shkurtra;
- shkruan një jetëshkrim të shkurtër personal, një tekst të shkurtër rrëfyes ose një tekst përshkrues duke respektuar strukturën e tij;
- jep disa gjykime rreth punëve të tij dhe të shokëve të klasës.

Niveli 4

Nxënësi:

- shkruan qartë dhe saktë hyrjen e një libri me kujtime;
- realizon dhe shkruan intervista të ndryshme, duke respektuar strukturën dhe rregullat gramatikore e drejtshkrimore;
- shkruan një jetëshkrim të shkurtër personal, një tekst përshkrues ose rrëfen ngjarje nga jeta e tij, duke respektuar strukturën dhe rregullat gramatikore e drejtshkrimore;
- vlerëson punët e tij dhe të shokëve të klasës.

Vlerësimi me pikë sipas niveleve është dhënë në tabelën e mëposhtme.

Niveli	Pikë
Niveli I	0- 4 pikë
Niveli II	5- 8 pikë
Niveli III	9- 12 pikë
Niveli IV	13- 15pikë

Në periudhën e tretë nxënësit do të vlerësohen si më poshtë:

Niveli 2

Nxënësi:

- përmbledh me një gjuhë të thjeshtë idetë kryesore një tekst rrëfyes ose përshkrues;
- bën 2-3 korrigjime të vogla të punët e tij ose të shokëve të klasës;
- realizon një prezantim të thjeshtë, duke iu përmbajtur temës së tij.

Niveli 3

Nxënësi:

- përmbledh një tekst rrëfyes ose përshkrues;
- redakton mirë punët e tij ose të shokëve të klasës;
- realizon një prezantim të mirë që i përmbahet temës.

Niveli 4

Nxënësi:

- sintetizon dhe përmbledh tekste rrëfyes, përshkrues etj.;
- redakton shkrime të ndryshme;
- prezanton me një gjuhë të qartë punën e tij, duke përdorur edhe TIK-un.

Vlerësimi me pikë sipas niveleve është dhënë në tabelën e mëposhtme.

Niveli	Pikë
Niveli I	0- 3 pikë
Niveli II	4- 8 pikë
Niveli III	9- 12 pikë
Niveli IV	13- 15pikë

Më poshtë përshkruhet modeli i një projekti kurrikular me shtrirje për një periudhë, në lëndën e gjuhës shqipe, klasa VIII.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi

Lënda: Gjuhë shqipe

Shkalla: IV

Klasa: VIII

Tema e projektit: Gazeta e shkollës sime

Kohëzgjatja e projektit/orët mësimore: 3 orë mësimore

Klasat pjesëmarrëse: Nxënësit e klasave të teta

Qëllimet e projektit:

- Të ndihmojë nxënësit të bëhen të vetëdijshëm për botën që i rrethon, të marrin vendime, të planifikojnë me shokët dhe shoqet, të bëhen prodhuesit dhe konsumatorët e fjalës së shkruar.
- T'i transformojë nxënësit në lexuesit, mbledhësit dhe shkruarit e lajmit, duke kulmuar me botimin e gazetës së klasës.

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi:

- identifikon qëllimin e shkrimit të gazetës;
- hulumton dhe përzgjedh llojin e duhur të informacionit për një gazetë;
- propozon tema të reja për gazetën e shkollës;

- përcakton formatin për gazetën e shkollës;
- identifikon elementet e strukturës së një artikulli (kush, kur etj.);
- shkruan shkrime letrare e joletrare për gazetën e shkollës;
- klasifikon artikujt e shkruar sipas llojit.

Konceptet kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit:

- Teksti letrar, poezia, tregimi
- Teksti joletrar
- Kronika
- Autobiografia
- Intervista
- Reportazhi
- Reklama
- Fjalët me ngjyrim emocional
- Gjuha standarde
- Kuptimi i figurshëm i fjalëve
- Funksionet gramatikore të fjalëve në fjali
- Shenjat e pikësimit
- Rregullat e drejtshkrimit

Partnerët: nxënës të shkollës, prindër, drejtues, mësues, gazetarë etj.

Veprimtaritë kryesore që do të kryhen për realizimin e projektit, afatet dhe personat përgjegjës.

Hapi I

U shpjegohet nxënësve qëllimi i projektit, rezultatet e të nxënësve që duhet të arrihen. Organizohet klasa në grupe. Çdo grup përbëhet nga 5-6 nxënës (gazetarët, redaktori, faqosësi, fotografi dhe shkruesi i reklamave). Anëtarët e grupit zgjedhin një drejtues, duke u mbështetur në kritere (vendosen kritere për drejtues grupi). Nxënësit i vendosin një emër grupit. Më pas ata hartojnë dhe firmosin marrëveshjen e punës në grup.

Grupi drejtues

Bëjnë pjesë përfaqësues të të gjitha grupeve. Ky grup ndjek punën e nxënësve, i këshillon dhe lehtëson kërkimin e tyre.

Ndahen çështjet për secilin grup. Çdo anëtar i grupit zgjedh një çështje të caktuar sipas aftësive dhe talenteve.

Nxënësit janë këshilluar që orën e parë të projektit të kenë me vete gazeta të ndryshme. Lexojnë artikujt e gazetave.

Ata punojnë në dyshe për të analizuar një artikull të përcaktuar nga gazeta. Më pas i shkëmbejnë mendimet e tyre me njëri-tjetrin dhe kalojnë në diskutime për artikullin.

Rikujtojmë strukturën e shkrimit të një artikulli në gazetë.

- Shkrimi në kolona
- Shkrimi i shkurtër

- Paragrafë të shkurtër me dy ose tri fjali
- Titulli i shkurtër e i figurshëm
- Emri i autorit
- Fjala përdoret në kuptimin e saj të parë
- Përmbajtja

Çdo artikull në gazetë ka një titull. Mund të jepen lajme lokale. Përmbajtja lidhet me këto pyetje: Kur? Ku? Kush? Çfarë? Pse?

Diskutim

- Sa ngjarje lexoni?
- Sa të gjata janë ngjarjet?
- A kanë të njëjtën gjatësi të gjitha?
- Cili kryeartikull është më i gjatë? Pse mendoni se është i tillë?
- A ka ilustrime në faqen e parë?
- Sa piktura ka në faqen e parë? A janë me ngjyra apo jo?
- Pse është e rëndësishme faqja e parë e gazetës?
- Çfarë pasqyrohet në faqet e tjera të gazetës?
- Cilat ilustrime pëlqeni më shumë? A janë ilustrimet në faqet e tjera të gazetës të ndryshme nga ato të faqes së parë?

Hartimi i planeve të punës për përgatitjen e gazetës dhe më pas prezantimi i ideve për krijimin e gazetës së klasës.

Ndarjet për secilin artikull.

Diskutime për emrin e gazetës.

Përcaktimi i detajeve të përgatitjes së gazetës, si: formati, përgjegjësitë, afatet etj.

Gazetarët

Secili nxënës merr temën e artikullit dhe përpiqet t'i kuptojë mirë dy anët e problemit, të gjurmtojë dhe të argumentojë se cila është më e rëndësishme.

Llojet e artikujve për t'u marrë në konsideratë janë: kryeartikulli, lajme, opinione, kuriozitete, lojëra, reklama (shitja e të cilave ndihmon për përfitimin e të ardhurave për botimin e gazetës në shkollë) etj.

Redaktori dhe faqosësi

Duhet të redaktojnë informacionet, për të rritur cilësinë e lajmit në formë dhe në përmbajtje.

Asnjë nxënës nuk duhet të redaktojë artikullin e vet. Faqosësi kujdeset për të mos lënë hapësira bosh, hapësira të bollshme midis fjalëve dhe rreshtave, midis titujve dhe përmbajtjes, midis fotove dhe tekstit. Në fillim vendosen artikujt, si dhe lihet hapësira ku do të vendosen ilustrimet.

Shkruesi i reklamave dhe fotografi

Këto nxënës punojnë për reklamën e gazetës. Ata përzgjedhin dy reklama për t'i diskutuar. Mund të reklamohet një produkt që nxënësit kanë dëshirë ta blejnë. Fotot duhet të lidhen me përmbajtjen e tekstit të shkruar.

Hapi II

Temat e artikujve lidhen me veprimtarinë brenda shkollës, me problematikat, aktivitetet dhe

problemet në komunitetin rreth shkollës. Nxënësit diskutojnë në grupe për arritjet sipas çështjeve. Redaksia do të lexojë kryeartikullin, artikujt. Vlerësohet se cili artikull duhet të botohet. Nxënësit kanë punuar me shkrim dore në skeda. Në këtë fazë ata shkruajnë në kompjuter. Më pas printohen dhe lidhen faqet e gazetës. Dhe në fund printohet gazeta për të gjithë nxënësit.

Hapi III

Krijimi i reklamave

Nxënësit do të bëjnë një reklamë për gazetën. Ata mund të realizojnë një reklamë udhëtimesh për vendlindjen e tyre ku mund të japin informacione historike, gjeografike, për klimën, për numrin e banorëve të krahinave nga vijnë, për objektet kulturore, për zhvillimin e folklorit, për gatimet tradicionale, për pikat turistike interesante etj.

Burimet kryesore të informacionit: Gjuha shqipe VIII, internet, gazeta, tekste letrare e joletrare, ndjekja nga afër e veprimtarive dhe problematikave në shkollë dhe komunitet.

Tematika e orëve të planifikuara për këtë projekt

Ora e parë: Planifikimi i gazetës

- Përcaktimi i qëllimit të projektit.
- Ndarja e përgjegjësisë për krijimin e gazetës.
- Përcaktimi i emrit të gazetës, formatit dhe afateve kohore.
- Përzgjedhja e tematikave të artikujve dhe të kryeartikullit për botim.

Ora e dytë: Prezantimi i punimeve të nxënësve.

- Shkëmbimi i mendimeve brenda grupeve për vazhdimësinë e punës.
- Prezantimi i një kryeartikulli dhe i artikujve të tjerë për gazetën.
- Redaktimi dhe faqosja.
- Përzgjedhja e fotove dhe e pikturave për ilustrime.

Ora e tretë: Prezantimit i produktit përfundimtar.

- Kjo ditë merr vlera festive. Ftohen nxënës nga të gjitha klasat dhe nga shkollat përreth, gazetarë, prindër, përfaqësues të biznesit në komunitet, drejtues e mësues nga shkolla.
- Ekspozitë me punimet e nxënësve.

Përshkrimi i produktit të projektit: Produkti përfundimtar do të jetë gazeta e titulluar “Sipërmarrësit”, 4 faqe, tematika përgjithësisht lidhet me organizimin e punës në shkollë, por edhe në komunitet. Një faqe për botimin e shkrimeve letrare. Artikuj shkencorë, artikuj për sportin, biznesin, puzzles, reklama etj.

Prezantimi

Gjatë prezantimit mund të ftohen nxënës nga klasat e tjera. Çdo grup përveç prezantimit me gojë

në mënyrë të plotë do të bëjë një prezantim në projektor dhe do të dorëzojë materialet.

Vlerësimi i nxënësve

Vlerësimi i nxënësve do të bëhet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit dhe në nivelet e arritjes. Pësia e këtij projekti në portofolin e nxënësit është *25 pikë*.

Niveli 2

Nxënësi:

- përdor 2-3 burime për të mbledhur informacion për tekstin që do të shkruajë në gazetë;
- shkruan një tekst të thjeshtë për gazetën, duke respektuar strukturën e tekstit;
- dallon artikujt kryesorë nga artikujt dytësorë në gazetë, duke u bazuar në tiparet e tyre;
- përzgjedh fotot dhe ilustrimet në funksion të përmbajtjes së tekstit;
- prezanton me një gjuhë të thjeshtë punën e tij para të tjerëve.

Niveli 3

Nxënësi:

- përdor disa burime për të mbledhur informacion për tekstin që do të shkruajë në gazetë;
- shkruan një tekst për gazetën, duke iu përmbajtur qëllimit, lexuesit dhe strukturës së tekstit;
- përcakton artikujt kryesorë dhe artikujt dytësorë, pasi i analizon ata;
- redakton mirë nga ana gjuhësore dhe letrare/shkencore tekstet në gazetë;
- përcakton fotot dhe ilustrimet në funksion të përmbajtjes së tekstit;
- prezanton mirë punën e tij para të tjerëve, duke respektuar faktorin kohë, si dhe duke përdorur TIK-un.

Niveli 4

Nxënësi:

- analizon dhe përzgjedh burime të rëndësishme për tekstin që do të shkruajë në gazetë;
- shkruan një kryeartikull për gazetën e shkollës, duke iu përmbajtur qëllimit, lexuesit, strukturës dhe formës së tekstit;
- vlerëson artikujt kryesorë dhe artikujt dytësorë në një gazetë;
- faqos në mënyrë estetike dhe funksionale tekstet, fotot dhe reklamat në gazetë;
- redakton saktë nga ana gjuhësore dhe letrare/shkencore tekstet në gazetë;
- përzgjedh në mënyrë kritike fotot dhe ilustrimet në funksion të përmbajtjes dhe të formës së tekstit;
- prezanton me gjuhë të qartë punën e tij, duke respektuar faktorin kohë, si dhe duke përdorur TIK-un.

Vlerësimi me pikë sipas niveleve është dhënë në tabelën e mëposhtme.

Nota	Pikë
4 (0- 24%)	0-5 pikë
5	6- 9 pikë
6	10-12 pikë
7	13- 16 pikë

8	17-19 pikë	
9	20- 22 pikë	
10	23-25 pikë	

10 PLANIFIKIMI NË LËNDËN E GJUHËS SHQIPE

Planifikimi është një proces i rëndësishëm i zbatimit të kurrikulës, i cili i krijon mundësinë mësuesit të jetë krijues dhe i lirë në procesin e mësimdhënies. Për një planifikim të mirë, mësuesi duhet të njohë dokumentet e mëposhtme:

- Kornizën kurrikulare të arsimit parauniversitar
- Kurrikulën bërthamë për AMU (klasat 6-9)
- Programin e gjuhës shqipe

Baza e një planifikimi të suksesshëm është njohja e mirë e programit mësimor. Mësuesi duhet të zbatojë me përpikëri të gjitha kërkesat e këtij programi. Rezultatet e të nxënit janë një themel i përbashkët për të gjithë mësuesit. Ata përzgjedhin vetë metodat dhe strategjitë më të përshtatshme, burimet e mundshme për t'u shfrytëzuar, llojet dhe mjetet e vlerësimit.

10.1 Llojet e planifikimeve

Planifikimi i mësimdhënies për lëndën e gjuhës shqipe përfshin:

- Planifikimin vjetor
- Planifikimin për secilën periudhë (shtator-dhjetor; janar-mars; prill-qershor)
- Planifikimin ditor

Në fillim të vitit shkollor mësuesi duhet të dorëzojë në drejtorinë së shkollës *planin vjetor* të lëndës, i cili shërben si një kornizë e ndarjes së përgjithshme të përmbajtjes lëndore dhe të orëve mësimore, si edhe *planin e periudhës së parë* (shtator- dhjetor). Planet e periudhës së dytë dhe të tretë dorëzohen para fillimit të secilës periudhë.

Gjatë vitit, sipas rrethanave që i krijohen, mësuesi mund të bëjë ndryshime në planin fillestar mësimor. Mësuesi mund të vendosë të përparojë më ngadalë nga sa e ka parashikuar, kur vë re se nxënësit e tij hasin vështirësi. Në këtë mënyrë mësuesi planifikon duke u bazuar në përparimin e nxënësve dhe në vështirësitë e hasura në periudhat paraardhëse, duke u përqendruar te arritjet e kompetencave kyç dhe të lëndës.

Më poshtë janë dhënë sqarime rreth planeve të mësipërme, për të cilat IZHA ka hartuar disa formate *sugjeruese*.

10.2 Planifikimi vjetor i lëndës

Për planifikimin vjetor të lëndës, mësuesi, përveç programit mësimor, duhet edhe të njohë edhe tekstin që ka përzgjedhur për atë vit shkollor. Natyrisht, realizimi i programit është qëllimi i vërtetë i mësuesit, kurse teksti mësimor i përzgjedhur është një mjet për ta përmbushur këtë qëllim. Kur mësuesi sheh se teksti nuk i ka dhënë vendin e mjaftueshëm përvetësimit të një rezultati të nxëni të programit, ai e plotëson vetë këtë mungesë të tekstit, duke përdorur burime të tjera të nxëni.

Plani vjetor është një plan sintetik. Mësuesi planifikon orët dhe përmbajtjen kryesore lëndore për tri periudha. Periudhat janë:

- periudha e parë: shtator- dhjetor;
- periudha e dytë: janar - mars;
- periudha e tretë: prill- qershor.

Formati i planit mësimor vjetor përmban këto rubrika:

- **Kompetenca:** Në këtë kolonë, renditen kompetencat e programit. Gjatë çdo ore mësimi nxënësit zhvillojnë kompetencat. Përcaktimi i orëve për një kompetencë nuk nënkupton që nxënësit punojnë vetëm ato orë për ndërtimin dhe zhvillimin e një kompetence, por gjatë atyre orëve punohet më shumë për njohuritë dhe aftësitë e saj.
- **Shpërndarja e përmbajtjes kryesore të lëndës sipas tri periudhave:** Në këtë kolonë vendoset përmbajtja kryesore e lëndës që do të zhvillohet në secilën periudhë dhe për secilën secilën tematikë. Gjithashtu, vendoset edhe totali i orëve për secilën periudhë, ku përfshihen njohuri, projekte, përsëritje, biseda letrare, teste etj.

Model i një plani vjetor në lëndën e gjuhës shqipe, klasa IX

KOMPETENCAT	SHPËRNDARJA E PËRMBAJTJES SË LËNDËS		
	SHTATOR – DHJETOR	JANAR–MARS	PRILL–QERSHOR
Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme (8 orë)	2 orë (tekste jo letrare: reklamë, udhëzim)	3 orë (tekste letrare: poezi, tregime)	2 orë (tekste jo letrare: kronikë, fjalim) - Përcaktimi i dëgjuesit të një teksti (<i>Kujt i drejtohet teksti?</i>). - Dallimi i vërtetësisë së një teksti.

Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar (7 orë)	3 orë (filmi, leximi, interneti) Elementet e komunikimit jo verbal dhe rëndësia e tyre gjatë të folurit.	3 orë (mjedisi, teatri, poezia) Rëndësia e përdorimit të gjuhës standarde gjatë të folurit. Lidhja e letërsisë me artet: muzika, piktura, skulptura, koreografia, filmi etj.	1 orë (muzika) Organizimi i një diskutimi ose i një debati.
Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare (65 orë) 70% e orëve tekste letrare Për tekstet letrare, mësuesi përzgjedh nga teksti mësimor, tekste poetike, tekste në prozë dhe tekste dramatike. 30% e orëve tekste jo letrare	23 orë - Tekste letrare (shqipe dhe botërore), - Gjinitë letrare dhe tiparet kryesore të tyre. - Figuracioni letrar. - Elementet kryesore e stilit dhe të gjuhës. - Rima dhe strofat në një tekst poetik. - Vargu i lirë në një poezi. - Tiparet e poezisë lirike. - Tiparet e poezisë epike. - 2 orë bisedë letrare. - 2 orë projekt.	20 orë - Tekste joletrare - 2 orë bisedë letrare - 1 orë projekt.	22 orë - Tekste letrare - Proza poetike. - Subjekti i një proze. - Tiparet kryesore të disa teksteve në prozë (tregimi, novela, romani). - Rrëfimtari, veta dhe koha e rrëfimit. - Elementet e strukturës së një teksti dramatik. - Monologu, dialogët në një tekst dramatik. - 2 orë bisedë letrare. - 2 orë projekt.
Të shkruarit për qëllime formale dhe funksionale (20 orë)	7 orë - Shkrimi i një poezie ose i një proze poetike, ose i një tregimi rreth një teme të caktuar, të përcaktuar nga mësuesi ose të zgjedhur nga vetë nxënësit. - Dramatizimi me shkrim i një	8 orë - Ese. - Plan veprimtarish për ngjarje, festa e përvjetorë të ndryshëm (p.sh., me rastin e një përvjetori të hapjes së shkollës së tij, me rastin e një feste lokale etj.). - CV. - 1 orë test	9 orë - Përshkrimi i mbresave të nxënësit gjatë nëntë viteve të shkollës. - Kthimi i një poezie në një tregim ose në prozë poetike. - Njoftim ose ftesë formale (p.sh., një ftesë për ceremoninë e mbarimit të shkollës 9-vjeçare). - 2 orë projekt

	tregimi të shkurtër. – Përshkrimi i përvojës së parë si spektator në një shfaqje dramatike. – 1 orë test		– 1 orë test
Përdorimi i drejtë i gjuhës (60 orë)	22 orë - Sintaksë - 1 orë vlerësim i portofolit të nxënësve	20 orë - Morfologji, - Fjalëformim - 2 orë projekt - 1 orë vlerësim i portofolit të nxënësve	18 orë - Drejtshkrim - Leksikologji dhe semantikë - 1 orë vlerësim i portofolit të nxënësve
Orë përsëritje për provimet kombëtare të arsimit bazë (15 orë)		4 orë përsëritje për provimet kombëtare të arsimit bazë	11 orë përsëritje për provimet kombëtare të arsimit bazë

Shënim: Ky model është orientues. Ai nuk përkon me ndonjë nga tekstet mësimore të gjuhës shqipe. Mësuesi, kur harton planin vjetor duhet t'i referohet edhe tekstit mësimor që ka zgjedhur.

Në modelin e mësipërm janë parashikuar edhe:

- 9 orë projekte (1 projekt gjatë dy periudhave të para dhe një projekt për periudhën e tretë).
- 3 teste për të tria periudhat. Sugjerohet që mësuesi të mos e planifikojë testin në fund të periudhës, për të shmangur ngarkesën e nxënësve (P.sh., testi i periudhës së parë mund të zhvillohet edhe në fillim të dhjetorit).
- 3 orë për vlerësimin e portofolit të nxënësve. Sugjerohet që mësuesi të mos e planifikojë vlerësimin e portofolit të nxënësve në fund të periudhës, për të shmangur ngarkesën e nxënësve
- 6 orë biseda letrare. Veprat ose fragmentet për bisedat letrare duhet të jenë letërsisë shqipe dhe botërore, të periudhave të ndryshme, të gjinive të ndryshme, të autorëve të ndryshëm. Mësuesi duhet të prezantojë që në fund të vitit shkollor, veprat që do të zhvillojë me nxënësit gjatë vitit të ardhshëm shkollor, në mënyrë që nxënësit të kenë mundësi dhe kohë t'i lexojnë ata gjatë pushimeve verore, ose mund t'i prezantojë në fillim të vitit shkollor. Gjithashtu,

veprat duhet të përzgjidhen brenda listave rekomanduese të MASR-së dhe mund të përdoren librat që janë në bibliotekën e shkollës.

10.3 Planifikimi sipas periudhave

Planifikimi i periudhës është një planifikim më afatshkurtër dhe më i detajuar i mësimdhënies. Ky lloj planifikimi kërkon që mësuesi të përcaktojë me kujdes rezultatet e të nxënësve të kompetencave kyç dhe rezultatet e të nxënësve të kompetencave të lëndës, të cilat do t'i realizojë brenda periudhës, në varësi të cilave përcakton dhe përmbajtjet mësimore që do të zhvillojë gjatë kësaj periudhe, orët mësimore brenda të cilave ato do të realizohen, duke planifikuar paraprakisht situatat e të nxënësve përmes të cilave do të mundësohet zhvillimi i kompetencave, burimet e të nxënësve, metodologjitë e mësimdhënies, si dhe llojet e vlerësimit dhe instrumentet vlerësuese.

Plani i një periudhe është analitik dhe në të detajohen temat mësimore që do të zhvillohen përgjatë saj. Mësuesi harton planin e periudhës përkatëse në fillim të saj dhe e dorëzon në drejtorinë e shkollës para fillimit të periudhës. Ky plan hartohet duke iu përmbajtur programit dhe tekstit mësimor përkatës.

Në planet sipas periudhave planifikohen të gjitha orët. Mësuesit janë të lirë të bëjnë ndryshimet e tyre hap pas hapi në varësi të specifikave të lëndës së tyre.

Formati i planit të një periudhe

Formati i planit të një periudhe përmban rubrikat e mëposhtme. Në format janë dhënë shembuj të organizimit të orëve mësimore. Duke qenë se gjuha shqipe zhvillohet 5 orë në javë, sugjerohet që dy ditë lënda të zhvillohet nga 2 orë të njëpasnjëshme (45+ 45 minuta) dhe në një orë 45-minutëshe. Siç shihet testi përmbledhës dhe vlerësimi i portofolit të nxënësit nuk janë planifikuar në fund të periudhës.

Shembull: Klasa VIII⁴

Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyç
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Nxënësi: 1. shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të

⁴ Shembulli nuk përkon me tekstet shkollore të lëndës së gjuhës shqipe. Ai shërben për të orientuar mësuesit në hartimin e planit të periudhës.

tjera të komunikimit;

2.

Kompetenca e të menduarit

Nxënësi:

1. shpreh mendimin e tij për një punim letrar apo artistik duke dalluar ndryshimet dhe analogjitë ndërmjet krijimeve të ngjashme;

2. ...

Kompetenca

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës

Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme

Nxënësi:

- jep mendimet dhe gjykimet e tij rreth teksteve që dëgjon;

-

Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar

Nxënësi:

- zgjedh formën e përshtatshme për të përcjellë informacionin, idetë, ndjenjat dhe pikëpamjet e tij;

- ...

Të lexuarit

-

Nr.	⁵ Kompetenca	Nr/k	Temat mësimore	Situata e të nxënit	Burimet
1.	F	1/1	Komunikimi dhe rëndësia e tij	Komunikimi në jetën e përditshme	Teksti mësimor
2.	L /letrar prozë	3/1	Fragment nga “Kronikë në gur” Kadare	Fëmijëria jonë	
3.	L /letrar Prozë	3/2	Fragment nga “Kronikë në gur” Kadare	Fëmijëria jonë	
4.	PDGJ	5/1	Emri (Morfologji)	Pushimet e mia	
5.	PDGJ	2/2	Gjinia e emrit. Gjinia asnjënjëse (Morfologji)	Pushimet e mia	
6.					
12	SH	4/1	Të shkruarit e përmbledhjes - Përmbledhja e përrallës	Struktura e një teksti dhe përmbledhja e tij	...
13	SH	4/2	Të shkruarit e përmbledhjes -	Shkrimi i përmbledhjes së një teksti	...

⁵ D- Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme

F- Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar

L- Të lexuarit e teksteve letrare dhe jolettrare

SH- Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

PDGJ-Përdorimi i drejtë i gjuhës

			Përmbledhja e përrallës		
34	...	...	Projekt “...” (ora e dytë)		...
35	...	...	Projekt “...” (ora e tretë)		...
48	...	...	Vlerësim i portofolit të nxënësve	...	...
50	SH	...	Qortime të punëve me shkrim		Punët me shkrim
54.	SH	...	Test përmbledhës për periudhën e parë		
64					
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Gjatë orëve të mësimit do të përdoren metoda, teknika dhe strategji të tilla si: diskutim për njohuritë paraprake, kubimi, diagrami piramidal, lexim i drejtuar, imagjinata e drejtuar, parashikim me terma paraprakë, harta e konceptit, rrjeti i diskutimit, pyetje autorit, ditaret e të nxënësve, pyetja sjell pyetjen, stuhi mendimi, diagrami i Venit etj. Nxënësit do të punojnë në grupe të vogla dhe të mëdha, në çift, në mënyrë të pavarur dhe individuale etj.					
Vlerësimi Disa nga teknikat dhe instrumentet e vlerësimit do të jenë: vlerësim i vazhdueshëm me gojë, vlerësim i punëve me shkrim, vlerësim i projekteve, teste, vlerësim i bisedave ose i leximeve jashtë klase, vlerësim i diktimit/eve etj.					

Plani i periudhës ka këto rubrika:

Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyç

Në këtë rubrikë mësuesi do të vendosë rezultatet e të nxënësve të kompetencave kyç, të cilat do të zhvillohen nga nxënësit përgjatë temave mësimore, të zhvilluara gjatë kësaj periudhe. Mësuesi i përzgjedh këto rezultate në programin mësimor, te rubrika “Rezultatet kryesore të të nxënësve, sipas kompetencave kyç që realizohen nëpërmjet lëndës së gjuhës shqipe”.

Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të lëndës

Në këtë rubrikë vendosen rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës, të cilat do të arrihen nga nxënësi nëpërmjet zhvillimit të këtyre temave mësimore. Mësuesi i përzgjedh këto rezultate të nxënësve nga programi mësimor. P.sh., *gjatë periudhës së parë, nga kompetenca “Përdorimi i drejtë i gjuhës” mund të zhvillohen vetëm tema nga morfologjia, prandaj mësuesi do të përzgjedhë vetëm rezultate të nxënësve që kanë lidhje me morfologjinë.*

Nxënësi:

- përcakton klasat e fjalëve dhe kategoritë e tyre gramatikore;
- dallon mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe.

Numri rendor

Këtu vendosen numrat për temat mësimore. Totali i numrave në planin e periudhës përkon me numrin e orëve që janë përcaktuar në planin vjetor të lëndës.

Kompetenca

Në këtë rubrikë shënohen kompetencat mbi të cilat është ndërtuar programi i lëndës. Këtu mund të specifikohen edhe ndarjet:

- tekste letrare dhe tekste jo letrare (70 %- 30%).
- tekst letrar poetik, në prozë, dramatik (afërsisht 12, 30, 37).
- morfologji, sintaksë, leksikologji dhe semantikë, fonetikë, drejtshkrim.
- etj.

Tema mësimore

Në këtë rubrikë shënohen të gjitha temat mësimore që do të zhvillohen gjatë periudhës. Mësuesi, përveç temave që i korrespondojnë tekstit mësimor, planifikon edhe orë për projektin, orë për testin ose detyrën përmbledhëse, orë për përmbledhjet ose përsëritjet etj. Gjithashtu, mund të planifikohen edhe orë për diskutimin dhe vlerësimin e portofolit.

Situata e të nxënit

Në këtë rubrikë vendosen situatat e të nxënit që mësuesi parashikon të realizojë gjatë periudhës, të cilat mund të ndryshohen dhe plotësohen përgjatë zhvillimit të lëndës. Situatat e të nxënit mund t'i përkasin një teme mësimore, disa temave mësimore, ashtu sikurse mund të ketë tema mësimore për të cilat mësuesi nuk zhvillon situata të nxëni. Me situatë të nxëni kuptohet ndërtimi i njohurive nëpërmjet një situatë praktike ose reale.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Në këtë rubrikë mësuesi vendos teknikat dhe metodat e mësimdhënies (p.sh., harta e konceptit, parashikimi me terma paraprakë, grupet e ekspertëve, punë në grup etj.) që do të përdoren gjatë zhvillimit të këtyre temave në një periudhë të caktuar (jo shumë e detajuar sepse e tillë kjo rubrikë detajohet në planifikimin ditor).

Vlerësimi

Këtu vendosen teknikat e vlerësimit që do të përdoren gjatë zhvillimit të këtyre temave në një periudhë të caktuar si p.sh., vlerësimi i përgjigjeve me gojë; vlerësimi i punës në grup; vlerësim mes nxënësish; vlerësim i aktivitetit gjatë debateve në klasë; vlerësim i detyrave të shtëpisë; vetëvlerësim; intervistë me një listë treguesish; vëzhgim me një listë të plotë treguesish; portofol, prezantim ose punë me gojë ose me shkrim, projekt kurrikular etj. Kjo rubrikë detajohet në planifikimin ditor.

Burimet

Në këtë rubrikë mësuesi vendos burimet që do të përdoren për arritjen e rezultateve të të nxënit si p.sh., teksti i nxënësit, libri digjital, teksti i ushtrimeve (nëse ka të tillë), vepra të ndryshme etj. Kjo rubrikë nuk plotësohet në mënyrë shumë të detajuar, pasi e tillë do të plotësohet në planin ditor.

10.4 Planifikimi ditor

Mësuesi planifikon çdo orë mësimore. Në përgatitjen e një plani ditor mësuesi duhet të përcaktojë rezultatet e pritshme të asaj ore mësimi, të përgatisë veprimtaritë mësimore, të përzgjedhë metodat dhe strategjitë, të përzgjedhë burimet e të nxënit, të përcaktojë teknikat e vlerësimit të përshtatshme për klasën, të parashikojë punën me klasën, grupet, nxënës të veçantë, të parashikojë lidhjen me lëndët e tjera etj.

Në ndryshim nga planifikimi tradicional, në planifikimin e kurrikulës me kompetenca kemi këto ndryshime:

Planifikimi (tradicional) i orës së mësimit	Planifikimi bazuar në kompetenca i orës së mësimit
Në planifikim përcaktohet çfarë bën mësuesi për të realizuar mësimin.	Në planifikim përcaktohet çfarë bëjnë nxënësit ndërsa realizohet mësimi (situatat, veprimtaritë, detyrat).
Mësimi përqendrohet pothuajse te përmbajtja.	Mësimi përqendrohet mbi proceset dhe veprimtaritë.
Mësimi ka pothuajse të njëjtin organizim të orës së mësimit.	Mësimi nuk ka të njëjtën metodologji gjithmonë. Organizimi varet nga rezultatet që duam të arrijmë.

Roli i mësuesit është kryesisht ligjërues (shpjegon).	Roli i mësuesit është organizator dhe theksi vihet te bashkëveprimi i nxënësve.
---	---

Rubrikat e planit ditor

Më poshtë jepet formati i sugjeruar i një plani ditor:

- Fusha (Gjuhët dhe komunikimi)
- Lënda (Gjuhë shqipe)
- Shkalla (shënohet shkalla, duke iu referuar kornizës kurrikulare, III dhe IV)
- Klasa (shënohet klasa/at)
- Tema mësimore (shënohet tema mësimore)
- Situata e të nxënësve (këtu shkruhet shkurtimisht tema e situatës së të nxënësve), nëse mësuesi ka planifikuar një situatë. Nëse mësuesi nuk planifikon situatë për atë temë mësimi, nuk do të shkruajë asgjë në këtë rubrikë.
- Rezultatet e të nxënësve (këtu vendosen rezultatet e temës mësimore që nxënësi do të arrijë gjatë orës së mësimi).
- Fjalët ose konceptet kyçe të temës mësimore.
- Burimet që do të përdoren gjatë orës së mësimi.
- Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare, nëse ka.
- Metodologjia ose veprimtarinë e nxënësve (metodologjia për arritjen e rezultateve të të nxënësve të orës së mësimi dhe veprimtaritë e nxënësve lidhen me situatën e të nxënësve, nëse është planifikuar një e tillë).
- Vlerësimi (shënohen teknikat e vlerësimit).
- Detyrat e shtëpisë (shënohen detyrat e shtëpisë, nëse do të jepen).

10.5 Modele planifikimi ditor (me orë të njëpasnjëshme 45 +45)

- a) Modeli i mëposhtëm është për dy orë të njëpasnjëshme në klasën e gjashtë (Të lexuarit, tekst letrar).

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Mitrush Kuteli “Fuqia e Mujit” , Shënim: Ky tekst mund të punohet 2 orë mësimi.		Situata e të nxënësve: Këngët tona legjendare	
Rezultatet e të nxënësve Nxënësi: - tregon brendinë e tekstit duke u përqendruar në pjesët kryesore; - ndan tekstin në pjesë dhe e përmbledh çdo pjesë me një		Fjalët kyçe: , Cikli i Kreshnikëve, Muji, Halili, zanat, hiperbola.	

fjali; - analizon figurën e Mujit dhe të zanave; - lidh jetën dhe përvojat e tij me ato të personazheve; - dallon hiperbolën në tekst dhe tregon funksionin që kryen; - shpreh dhe argumenton pëlqimet e tij për tekstin që lexon.	
Burimet: Teksti i nxënësit, foto dhe ilustrime nga Cikli i Kreshnikëve.	Lidhja me fushat/lëndët e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Art pamor, histori.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve


Organizimi i orës së mësimi:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Diskutim

Mësuesi i pyet nxënësit rreth njohurive të tyre dhe rreth informacionit të mbledhur për Ciklin e Kreshnikëve.

- Çfarë dini për Ciklin e Kreshnikëve?
- Cilat janë personazhet e këtij cikli?
- Për çfarë luftojnë Muji dhe Halili?
- Çfarë dini për zanat? Si i imagjinoni ato? (*klaster*)



Ndërtimi i njohurive të reja

a) Prezantim i disa fotove për nxitjen e imagjinatës së nxënësve

Mësuesi prezanton disa foto nga Cikli i Kreshnikëve dhe kërkon nga nxënësit përshtypjet e tyre.

- Ç'përshtypje ju bëjnë këto foto?
- Si portretizohet Muji? Çfarë ju pëlqen më shumë te ai?

b) Prezantimi i pjesës së re

Mësuesi zhvillon një bisedë hyrëse në të cilën prezanton titullin e pjesës, autorin (Mitrush Kuteli) dhe përpjekjet dhe vlerat e tij në përshtatjen e disa këngëve të Ciklit të Kreshnikëve në prozë, në vëllimin

“Tregime të moçme shqiptare”.

c) Parashikim me terma paraprakë

Mësuesi prezanton para nxënësve 5 fjalë kyç dhe kërkon nga nxënësit të krijojnë një histori me to (nxënësit mund të punojnë edhe në grupe). Fjalët kyç janë: Muji, foshnja, zana, gji, fuqi, ëndërr.

Nxënësit prezantojnë punët e tyre.

d) Kuptimi i tekstit

→ **Lexim i pjesës nga nxënësit**

Nxënësit lexojnë me kujdes tekstin. Mësuesi i udhëzon që nxënësit të nënvizojnë fjalët që nuk ua dinë kuptimin dhe janë të panjohura për ta. Më pas mësuesi sqaron kuptimin e tyre dhe kërkon nga nxënësit të ndërtojnë fjali me to (bjeshkë, kreshnik, kullotë, mriz, nginj etj.).

→ **Pyetje rreth brendisë së tekstit**

Mësuesi pyet ose nxit nxënësit të bëjnë pyetje:

- Çfarë ndodhi pas mesnate?
- Çfarë po bënte Muji?
- Si e pritën zanat përkujdesjen e Mujit ndaj foshnjave?
- Çfarë u kërkoi Muji zanave?
- Sa fuqi merr Muji prej zanave?
- Si përfundon kjo ngjarje? A ishte në ëndërr Muji?

Shënim: Çdo përgjigje duhet shoqëruar me ilustrime nga teksti (fragmenti).

→ **Ndarja e tekstit në pjesë dhe vënia e një titulli për çdo pjesë.**

Mësuesi ndan nxënësit në çifte (sipas tavolinave) dhe u kërkon të ndajnë tekstin në pjesë dhe t’i vënë një titull çdo pjese. P.sh.:

- Muji përkundi foshnjat e zanave.
- Zanat i thonë Mujit që të kërkojë çfarë të dojë prej tyre?
- ...

e) Interpretimi dhe vlerësimi

→ **Analizë personazhesh**

Sa personazhe prezantohen në këtë tekst? Cilët janë ata?

Muji

- Cili është personazhi kryesor në këtë tekst?
- Çfarë është Muji?
- Ku duket mirësia e tij?
- Pse Muji zgjedh t’u kërkojë fuqi zanave?
- A e vlerëson Muji ndihmën e zanave? Çfarë u ofron në këmbim atyre?

Zanat

- Si përshkruhen zanat në këtë tekst?
- Janë krijesa reale apo imagjinare?
- Si i imagjinoni ju ato?
- Si mendoni ju, pse zanat i kishin lënë foshnjat? Kishin punë apo për të provuar Mujin? Ku duket kjo? *(kur thonë që e njohin Mujin dhe se ndihmojnë njerëzit e mirë).*

Ora e dytë

→ **Lidhja e tekstit me përvojat e nxënësve (diskutim)**

- Si do të vepronit ju në vend të Mujit?
- Çfarë do t’u kërkonit zanave? Pse?

f) Gjuha e fragmentit

→ Nxënësit gjejnë fjalët me të cilat realizohet përshkrimi i natyrës dhe veprimet e Mujit. Fjalët i ndan sipas klasave: emra ose folje

Klasat e fjalëve	Emër	Folje
Përshkrimi i natyrës	Shkëmb, bjeshkë, mriz etj.	

Veprimet e Mujit	Përkund, kap, shkëlq
-------------------------	----------------------

Mësuesi orienton nxënësit që përshkrimi i natyrës bëhet me emra, ndërsa veprimet shprehen me folje.

→ **Hiperbola (hartë koncepti)**

- Nga shembujt e përdorimit të foljeve për veprimet e Mujit, kalohet te figura e hiperbolës. Mësuesi bën një hartë koncepti për hiperbolën (Çfarë është? Cili është funksioni? Shembuj).
- Hiperbola në fragment (Nxënësit gjejnë në fragment rastet e përdorimit të hiperbolës në fragment).
- Nxënësit kujtojnë shembujt e përdorimit të hiperbolës nëpër përralla.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

→ **Ditaret e të nxënës**

Mësuesi fton nxënësit që në një fletë fletoreje të ndarë me një vizë në mes. Në njërën anë ata mund të shkruajnë ndonjë pjesë, fjali ose shprehje që ju pëlqen më shumë dhe në anën tjetër mund të shkruajnë një koment ose një arsye pse ju pëlqen. Më pas nxënësit prezantojnë gjetjet ose shënimet e tyre.

Pjesa që më pëlqen	Argumenti
Kur të jem ngushtë, do t'ju thërras të vini të më jepni dorën; kur t'ju fyejë ndokush, të më thërrisni e unë do të hidhem t'ju marr krahun.	Kjo pjesë më pëlqen sepse....

Vlerësimi: Mësuesi mban shënime në evidencë për disa nxënës që demonstrojnë njohuri rreth Ciklit të Kreshnikëve, aftësi për të kuptuar, për të interpretuar dhe për të vlerësuar tekstin e Mitrush Kutelit, si dhe për të analizuar personazhet e tekstit.

Niveli 2:

- tregon me fjalë të thjeshta brendinë e tekstit;
- përcakton 1-2 tipare të Mujit dhe të zanave;
- përkufizon hiperbolën;
- shpreh pëlqimet e tij për tekstin që lexon.

Niveli 3:

- tregon me gjuhë të rrjedhshme brendinë e tekstit;
- ndan tekstin në pjesë dhe e përmbledh çdo pjesë me një fjali;
- analizon figurën e Mujit dhe të zanave;
- lidh jetën dhe përvojat e tij me ato të personazheve;
- dallon hiperbolën në tekst;
- shpreh pëlqimet e tij për tekstin që lexon, dhe jep një argument për pëlqimet e tij.

Niveli 4:

- tregon qartë dhe me gjuhë të pasur brendinë e tekstit;
- analizon figurën e Mujit dhe të zanave, duke i konkretizuar me shembuj nga fragmenti;
- lidh jetën dhe përvojat e tij me ato të personazheve;
- dallon hiperbolën në tekst dhe tregon funksionin që kryen;
- shpreh dhe argumenton pëlqimet e tij për tekstin që lexon.

Detyrë shtëpie: Përshkruani personazhin e Mujit, duke u ndalur te pamja e tij e jashtme.

b) Modeli i mëposhtëm është për dy orë të njëpasnjëshme në klasën e shtatë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: “Prometeu i lidhur” Eskili (Të lexuarit e teksteve letrare)		Situata e të nxënës: Humanizmi në ditët tona	

Rezultatet e të nxënës të temës mësimore: Nxënësi: <i>Nxënësi:</i> - shpjegon fjalë e shprehje të reja nga fragmenti dhe i përdor në fjali sipas kontekstit; - interpreton në role prologun e tragjedisë “Prometeu i lidhur”; - tregon brendinë e fragmentit; - identifikon temën e trajtuar në fragment; - analizon personazhet; - shpjegon efektin stilistik të figurave letrare në prolog (epitetit, krahasimit etj.); - dallon veçoritë kryesore të tragjedisë; - planifikon vepra humane, duke u frymëzuar nga humanizmi në vepër.	Fjalët kyçe: tragjedi, konflikt.
Burimet: Gjuha shqipe VII, informacione rreth malit të Olimpikut dhe perëndive që jetonin në të, enciklopedi.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: arte, histori, gjeografi, TIK.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Organizimi i orës së mësimi <i>(Nxënësit janë vendosur në formë U-je dhe në grupe)</i> Në projektor shfaqen figura heronjsh mitologjikë. Skena është parapërgatitur për interpretimin në role. Nëpërmjet një pikture të madhe në të cilën pasqyrohet vendi ku zhvillohen ngjarjet dhe vepron personazhet (punuar nga vetë nxënësit). Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Detyra e shtëpisë Frymëzuar nga rruga e Virtutes që ndoqi Herakliu bëni një përshkrim (10 fjali) me temën: Heroizmi i parë që më duhet të bëj është të zgjedh rrugën e Virtytit” Lexohet detyra e shtëpisë. Vlerësimet rreth realizimit të detyrës. Stuhi mendimi: Heronjtë mitologjikë - Kush ishte Herakliu? Përse luftonte? - A mund të thoni emrat e disa prej heronjve të dëgjuar mitologjikë? - Kë pëlqeni më shumë? Pse? <i>Shënim:</i> Çdo argument pranohet, por nxënësit nxiten drejt mitit të Prometeut. Ndërtimi i njohurive të reja - Njihet nxënësit me temën e re mësimore, autorin, gjininë letrare ku bën pjesë fragmenti “Prometeu i lidhur”. - Jeta, veprimtaria dhe veprat letrare të Eskilit, subjekti i tragjedisë (nxënësit kanë lexuar paraprakisht fragmentin ‘Prometeu i lidhur’). Në projektor shfaqet Eskili dhe informacione rreth jetës dhe veprimtarisë së tij. <i>Karrigia e nxehtë:</i> Një nxënës ulet në qendër të klasës dhe luan në rolin e Eskilit. Nxënësit ndjekin rrëfimin dhe mund të drejtojnë pyetje për t’u qartësuar. Plotësohet në tabelë informacioni i nevojshëm për jetën dhe veprat letrare <i>Marrëdhëniet pyetje – përgjigje (20 minuta)</i> Lexohet fragmenti në role dhe gjatë leximit nxënësit veçojnë fjalë e shprehje që nuk i kuptojnë. Shpjegohen ato së bashku përmes kontekstit dhe ilustrohen me shembuj. <i>Të kuptuarit e fragmentit</i> Kalohet në zbatimin e përmbajtjes së fragmentit. U kërkohet nxënësve të ndërtojnë pyetje rreth tekstit, duke ndjekur një rrjedhë logjike. Përgjigjia shoqërohet me vargje nga fragmenti. Pyetjet ua drejtojnë anëtarëve të grupeve të tjera. Nëse nga nxënësit nuk drejtohen pyetjet e duhura rreth të kuptuarit,	

ndërhyhet me pyetje shtesë.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve rreth të kuptuarit.

- Nga është shkëputur kjo pjesë?
- Pse mendoni se tragjedia është titulluar ‘‘Prometeu i lidhur’’?
- Cilat janë personazhet që veprojnë në këtë prolog?
- Si e përshkruan Pushteti vendin ku do të mbërthehet Prometeu?
- Për ç’mëkat mendoni se Prometeun po e ndëshkojnë rreptë hyjnitë?
- Kujt ua rrëmbeu Prometeu zjarrin?
- Ku duket vuajtja dhe madhështia e Prometeut në emër të njerëzimit?
- Kujt i drejtohet ai me thirrjen e tij?
- Si reagon Hefesti, kur Pushteti i drejtohet për të zbatuar urdhrin e Zeusit?
- Si e përfytyroni korin e Nimfave?
- Cila është tema e trajtuar në prolog? Po nëntemat?

Vënie në skenë e një fragmenti nga ‘‘Prometeu i lidhur’’ 10 minuta

Klasa shndërrohet në një miniskenë të një teatri. Nxënësit kanë mësuar të interpretojnë në skenë sipas roleve dhe e kanë sjellë Prometeun të lidhur në pranga. Për ta mbërthyer te shkëmbi i thepisur është ngarkuar Hefesti, perëndia e zjarrit dhe farkëtarisë.

Nxënësit vlerësojnë interpretimin e shokëve dhe përcaktojnë një fitues.

Analizë personazhesh

Skeda e personazhit: 15 minuta

Secili grup do të punojë në skeda kartoni me forma të veçanta. Anëtarët e grupit kanë mjetet për t’i dhënë formë skedës sipas analizës. Pasi t’i plotësojnë skedat, i shkëmbejnë për të plotësuar.

Nxënësve u kërkohet të rikthehen në tekst për të analizuar personazhet.

Prometeu	Zeusi	Hefesti	Skeda e personazhit
Veprime	Mendimet		Anët e dobëta
Ndjenja	Anët e forta		Fjalët

Rrjeti semantik

Prometeu




Zeusi



Ditari dypjesësh

Figura letrare	Komenti im

Tiparet e tragjedisë: Kllaster (Duke iu referuar fragmentit nxënësit plotësojnë tiparet e tragjedisë).



Diskutim: Aktualizimi i mitit të Prometeut

- A njihni njerëz dhe personalitet që ashtu si Prometeu, luftojnë dhe bëjnë vepra në të mirë të njerëzve? Cilët janë ata? (Nënë Tereza, Skënderbeu etj.)
- Cilat janë të përbashkëtat dhe të veçantat mes tyre?

- Po në ditët e sotme a ka njerëz të tillë? Kë mund të përmendni? - Çfarë vlerësoni më shumë te Prometeu? Pse? - Ç'vëpër humane mund të bëjmë së bashku, frymëzuar nga Prometeu? Demonstrimi i rezultateve të arritura Shkrim i lirë: Lidhja e fragmentit me jetën e fëmijëve (<i>Letër Eskilit, autorit të tragjedisë "Prometeu i lidhur"</i>) - Pse do ta falënderoni autorin e tragjedisë?
Vlerësimi: Bëhet vlerësimi i orës së mësimit mbështetur në nivelet e arritjes dhe në rezultatet e të nxënit të temës mësimore. <i>Niveli 2:</i> - tregon brendinë e fragmentit; - përcakton 1-2 tipare të personazheve të fragmentit; - gjen figurat letrare në fragment; - shpreh me gjuhë të thjeshtë gjykimet e tij për fragmentin. <i>Niveli 3:</i> - tregon me gjuhë të rrjedhshme brendinë e fragmentit; - ndan tekstin në pjesë; - analizon personazhet; - lidh jetën dhe përvojat e tij me ato të personazheve; - gjen figurat letrare dhe tregon funksionin e tyre; <i>Niveli 4:</i> - tregon qartë me fjalor të pasur brendinë e fragmentit; - identifikon temën e trajtuar në fragment; - analizon konfliktin dhe personazhet në fragment; - shpjegon efektin stilistik të figurave letrare në prolog (epitetit, krahasimit etj.); - dallon veçoritë kryesore të tragjedisë.
Detyrat e shtëpisë Nxënësit përzgjedhin njërin nga detyrat e mëposhtme. - Mësoni përmendësh 15 vargje nga monologu i Prometeut. - Vizatoni Prometeun e mbërthyer në malin e Skithisë, duke u mbështetur në imagjinatën tuaj. - Përkthyeri ndjenjat që ju kanë mbërthyer, kur keni bërë një akt human.

11. VLERËSIMI I NXËNËSVE NË LËNDËN E GJUHËS SHQIPE

Roli kryesor i vlerësimit është të përmirësojë të nxënit. Informacioni i siguruar nga vlerësimi i ndihmon mësuesit të kuptojnë anët e dobëta dhe anët e forta të nxënësve në procesin e të nxënit dhe u jep mundësi të përmirësojnë mësimdhënien. Vlerësimi i nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe ka për synim matjen e kompetencave të lëndës, të paraqitura nëpërmjet rezultateve të të nxënit.

Mësuesi, në përputhje me parimet themelore të vlerësimit, siguron përdorimin e të gjitha llojeve të vlerësimit, të cilat përcaktohen si të domosdoshme për të gjykuar në lidhje me arritjet e nxënësve, në funksion të mbështetjes së të nxënësit dhe mësimdhënies.

Vlerësimi i nxënësit kryhet nëpërmjet:

- vlerësimit të vazhduar (vlerësimi për të nxënë) - 40%;
- vlerësimit me test/detyrë përmbledhëse (vlerësimi i të nxënësit) - 40%;
- vlerësimin i portofolit lëndor të nxënësit - 20%.

11.1 Nivelet e arritjeve

Arritjet e nxënësve regjistrohen dhe raportohen kundrejt niveleve të arritjes. Mësuesi duhet t'i përdorë nivelet e arritjes, kur merr një vendim për arritjet e nxënësve në lidhje me rezultatet e të nxënësit. Nivelet e arritjes përshkruajnë nivelin në të cilin nxënësi duhet të punojë për të arritur një nivel ose notë të caktuar.

(Shih zbërthimin e niveleve të arritjeve të modeli i planifikimit ditor apo të modeli i testit)

11.2 Vlerësimi i vazhduar

Vlerësimi i vazhduar bazohet në vëzhgimet dhe gjykimet e mësuesit mbi ***përgjigjet me gojë ose me shkrim, punët me shkrim, bisedat letrare, punët në grup, diskutimet e mësuesit me nxënësit, vetëvlerësimin e nxënësit, vlerësimin e nxënësit nga nxënësi, pjesëmarrjen në aktivitete dhe debatet në klasë, detyrat e shtëpisë apo të klasës etj.***, përgjatë një periudhe.

Për vlerësimin e vazhduar të arritjes së rezultateve të të nxënësit, mësuesi **mban shënime në evidencë për çdo nxënësi**. Shënimet në evidencë mund të mbahen me **simbole** etj., të shoqëruara me **komente**, të cilat u referohen niveleve të arritjes së kompetencave lëndore. Punët me shkrim (si në shembullin e mëposhtëm) do të vlerësohen me notë.

Për lehtësimin e punës së tij mësuesit i sugjerohet të shkruajë në fund të evidencës **një legjendë**, e cila shpjegon kuptimin e simboleve të vendosura.

Komentet i referohen **niveleve të arritjes së kompetencave lëndore** bazuar në dokumentin përkatës të “Niveleve të arritjes” shkallët 3-4 (klasat 6-9).

Shembull 1: Gjuhë shqipe (klasa VI)

Periudha: Prill- qershor

<i>Nr.</i>	<i>Nxënësi</i>	<i>14.04</i>	<i>04.05</i>	<i>13.05</i>	<i>24.05</i>	<i>03.06</i>	<i>Komentet janë: Nivelet e</i>
------------	----------------	--------------	--------------	--------------	--------------	--------------	---------------------------------

	/ Data						<i>arritjes për njohurinë/konceptin përkatës</i>
1	Elira Bardhi	+-					N2. Tekst jo letrar (tiparet kryesore të biografisë)
			✓				N3. Tekst letrar (interpretimi i poezisë)
				8			Punë me shkrim (tregim i shkurtër)
					+		N3. Bisedë letrare (tregime)
						+	N3. Familja e fjalëve

Legjendë: ++ (sh. mirë); + (mirë); +- dhe ✓ (mesatar); -+ dhe ? (nën mesatar); - dobët; - - (sh. dobët). N1- Niveli 1; N2 – Niveli 2; N3 – Niveli 3; N4 – Niveli 4. TN – test i ndërmjetëm

Në përfundim të periudhës tremujore, vlerësimi i vazhduar mbyllet me një notë përmbledhëse (NVv). Nota e vlerësimit të vazhduar në këtë rast gjykohet në bazë të ecures (progresit ose regresit) të arritjeve të nxënësit përgjatë periudhës, pra NVv është 8. Në shembullin e mësipërm ecuria e nxënësit është progresive, por mund të jetë edhe regressive.

Ndryshimi kryesor që ka ndodhur në vlerësimin e nxënësit gjatë zbatimit të kurrikulës së re është vlerësimi për të nxënë (vlerësimi i vazhduar). **Fokusi kryesor i vlerësimit për të nxënë (vlerësimit të vazhduar) është që nxënësi të përmirësojë të nxënën e tij, si dhe të motivohet më shumë për të mësuar.** Pra, vlerësimi për të nxënë nuk ka si qëllim kryesor vendosjen e një note, por të evidentojë të nxënësi pikat e forta dhe problematikat dhe ta ndihmojë që t'i përmirësojë ato. Në këto kushte, mësuesi duhet të fokusohet te procesi i të nxënës dhe jo te vendosja e notës.

Si dokumentohet vlerësimi i vazhduar (vlerësimi për të nxënë)?

- Fletorja personale dhe evidenca nënkuptojnë **të njëjtin dokument**. Pra, mësuesi ka vetëm një dokument për vlerësimin e vazhduar (vlerësimin për të nxënë).
- Mësuesi mban shënime në fletoren e tij personale (apo në evidencë) ecurinë e progresit të nxënësit lidhur me rezultatet e arritjes.

- Fletoren personale (evidencën) mësuesi *e formaton në mënyrën më të përshtatshme për të*, por duke ruajtur logjikën e vlerësimit për të nxënë. Me fletoren personale (evidencën) mësuesi është i lehtësuar nga ngarkesa ose nga presioni për të vënë nota në regjistër në mënyrë të vazhduar.
- Mësuesi është i lirë t'i mbajë shënimet në fletoren e tij personale (evidencë) duke vendosur *simbolet, që ai gjykon si të përshtatshme*, të shoqëruara me komente shumë sintetike, të cilat iu referohen niveleve të arritjes së kompetencave lëndore.
- Komenti përmban nivelin e arritjes duke e shënuar me simbolin përkatës (**p.sh., N₃ ose N₄**), si dhe *konceptin/konceptet përkatëse* për të cilin është vëzhguar nxënësi.
- Përgjigjet me gojë ose me shkrim, punët në grup, punët individuale, diskutimet e mësuesit me nxënësit, vetëvlerësimi i nxënësit, vlerësimi i nxënësit nga nxënësi, pjesëmarrjet në aktivitete dhe diskutimet në klasë, detyrat e shtëpisë apo të klasës etj., *vlerësohen me simbole*. Vendosja e notës në mënyrë të vazhduar gjatë vlerësimit për të nxënë nuk ndihmon procesin e të nxënit, motivimin e nxënësve për të nxënë dhe zhvillimin e kompetencave.
- Nota në fletoren personale (evidencë) mund të vendoset *vetëm* në raste specifike, siç janë testet e ndërmjetme apo punët me shkrim etj.
- Nota e vlerësimit të vazhduar që vendoset në regjistër në faqen “Vlerësimi periodik” duhet të jetë *rezultante progresive (ose regresive) e vlerësimeve që mësuesi ka mbajtur* në fletoren e tij personale.
- Fletorja personale (evidenca) *është objekt monitorimi, por nuk* duhet dorëzuar në përfundim të periudhës.
- Mësuesi *mban përgjegjësi për fletoren personale* dhe duhet të argumentojë notën e vlerësimit të vazhduar të vendosur në regjistër.
- Mësuesi duhet *të ruajë deri në përfundim të vitit shkollor* fletoren personale (evidencën), teste/detyra të ndërmjetme, punët me shkrim, etj. Këto do t'i shërbejnë për të argumentuar notën e vlerësimit të vazhduar.
- Drejtuesit e shkollave nuk duhet të ngarkojnë mësuesit me detyrimin për të mbajtur dy dokumente për vlerësimin e vazhduar të nxënësve: evidencën e vlerësimit të vazhduar dhe fletoren personale të shënimeve, ato janë e njëjta gjë.
- Gjatë periudhës, mësuesi i lëndës ka përgjegjësi për të informuar nxënësin për ecurinë dhe mundësinë e tij për progres.

11.3 Vlerësimi me portofol lëndor

Portofoli është koleksionim sistematik i detyrave dhe i punimeve krijuese dhe hulumtuese të kryera nga nxënësi përgjatë periudhës për të dëshmuar zhvillimin e kompetencave (njohurive, shkathtësive, qëndrimeve). Mësuesi udhëzon nxënësit për krijimin e portofolit dhe bashkëpunon me ta rreth përmbajtjes së tij. Në fillim të periudhës, mësuesi në bashkëpunim me nxënësit, përcaktojnë detyrat dhe punimet që do të përfshijnë në portofol përgjatë periudhës, në varësi të specifikave të lëndës. Këto detyra zhvillohen gjatë periudhës dhe nuk janë pjesë e vlerësimit të vazhduar (në evidencë), por vetëm pjesë e portofolit lëndor.

Për një periudhë, detyrat që vlerësohen në portofol janë:

📁 projekti ose një fazë e tij, e cila është pjesë e detyruar e portofolit për çdo periudhë;

📁 1 -2 detyra krijuese, zbatuese, hulumtuese etj.

Detyrat e portofolit duhet të jenë me të njëjtën temë për çdo nxënësi. Këto detyra mund të jenë punime të kryera në klasë dhe/ose jashtë saj, dëshmi e kontributeve dhe talentit të nxënësit, me karakter hulumtues dhe krijues të tilla si:

- punë praktike individuale;
- produkte të krijuara nga nxënësit;
- punime audio-vizuale;
- aktivitete në grup ose individuale;
- projekte individuale ose në grup;
- etj.

Kujdes! Detyrat **NUK** duhet të jenë domosdoshmërisht të punuara me kompjuter.

Si dokumentohet dhe vlerësohet portofoli?

- Mësuesi përcakton kriteret e vlerësimit të portofolit.
- Mësuesi në fillim të periudhës përcakton dhe iu prezanton nxënësve peshat/pikët për vlerësimin e secilës detyrë të portofolit dhe kriteret e vlerësimit të tij.
- Vlerësimi i secilës detyrë të portofolit bëhet mbi bazë të kriterëve që mësuesi vendos, duke u bazuar në llojin e detyrës së dhënë.
- Mësuesi ka përgjegjësi për vlerësimin e portofolit bazuar në kritere vlerësimi, duke argumentuar notën e tij.
- Instrumentet që mësuesi harton për kriteret e vlerësimit të portofolit ***nuk janë objekt monitorimi.***

- Detyrat e portofolit apo një fazë e projektit vlerësohen në momentin që ato dorëzohen ose prezantohen.
- Vlerësimi i portofolit mund *të planifikohet si orë e veçantë* në planifikimin e periudhave ose mund të realizohet përgjatë tri - katër orëve mësimore të periudhës.
- Mësuesi duhet të kujdeset që *të mos mbingarkojë nxënësin me detyra* në përfundim të periudhës. Ai, gjithashtu, mund të bashkërendojë punën me mësuesit e lëndëve të tjera për të shmangur ngarkesën e nxënësve.
- Vlerësimi i portofolit *jo domosdoshmërisht* bëhet në fund të periudhës. Mësuesi e gjykon vetë kohën se kur do të zhvillojë vlerësimin e portofolit.
- Në momentin që mësuesi ka përfunduar me *vlerësimin e detyrave të portofolit dhe të projektit ose të një faze të tij*, notat e portofolit i vendos në regjistër.
- Mësuesi duhet t'i udhëzojë nxënësit që t'i ruajnë detyrat e portofolit deri në përfundim të vitit shkollor ose t'i mbajë vetë këto detyra.

Në lëndën e gjuhës shqipe sugjerohet që përgjatë një periudhe, të përfshihen në portofol rreth 3 (tri) detyra të nxënësit, përfshirë projektin ose një nga fazat e tij. Pra, pjesë e portofolit është edhe projekti kurrikular. Projekti kurrikular mund të jetë i shtrirë vetëm brenda një periudhe, por mund të jetë i shtrirë (nëse është një) edhe përgjatë gjithë vitit. Sido që të jetë shtrirja e projektit ai ka vlerësimin e tij brenda vlerësimit të portofolit. Nëse projekti ka shtrirje përgjatë gjithë vitit, në çdo periudhë vlerësohet si pjesë e portofolit ajo pjesë e projektit që është realizuar. Në rastin kur ka shtrirje brenda një periudhe vlerësohet i gjithë projekti.

Për vlerësimin e portofolit, mësuesi përcakton kritere të qarta dhe ua komunikon nxënësve. Vlerësimi i detyrave të portofolit varet nga pesha që secili mësues i vendos secilës detyrë.

Rubrikat e portofolit mund të grupohen në:

- punë dhe detyra të kryera në klasë dhe jashtë saj;
- projekte individuale ose në grup;
- detyra dhe kontribute të pavarura të nxënësit, të cilat janë dëshmi e talentit, e hulumtimeve praktike, e punëve tematike (me shkrim, audio-vizuale etj.).

Në shembullin më poshtë, mësuesi në bashkëpunim me nxënësit ka përcaktuar detyra për portofolin e periudhës së parë, i cili do të ketë gjithsej 50 pikë. Për vlerësimin e portofolit mësuesi **përcakton vetë** pikët/peshat për secilën detyrë.

Më poshtë janë dhënë **dy shembuj**, pikët/peshat e të cilëve shërbejnë **thjesht** për të ilustruar modelin dhe mund të mos përdoren domosdoshmërisht nga mësuesi.

Shembull 1:

- a) Përshkruani ngjashmëritë dhe dallimet mes jush dhe një personazhi të pëlqyer nga ju. 10 pikë
- b) Projekti “Përgatitja e një reviste për fëmijë” (faza e parë). Përzgjedhja e rubrikave dhe mbledhja e informacionit kryesor. 20 pikë
- c) Gjetja e rasteve të përdorimit të gabuar të shkronjës së madhe në jetën e përditshme, si p.sh.: në meny, në tabela të ndryshme, në televizion, në libra etj. 20 pikë

Vlerësimi me pikë

Detyra	Detyra 1	Detyra 2	Detyra 3	Portofoli
Nota	8 pikë	14 pikë	14 pikë	36 pikë

Sipas tabelës së vlerësimit me notë (si në rastin e vlerësimit të testeve), vlerësimi i këtij portofoli është nota 8 (tetë).

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-12	13- 19	20-26	27 - 32	33-38	39-44	45-50

Shembull 2

- a) Një përmbledhje të shkurtër të një libri që keni lexuar gjatë pushimeve. 10 pikë
- b) Projekti “Udhëtoj drejt vendlindjes”. Prezantimi individual i projektit. 20 pikë
- c) Ktheni një përrallë të shkurtër në gjuhën standarde. 5 pikë

Vlerësimi me pikë

Detyra	Detyra 1	Detyra 2	Detyra 3	Portofoli
Nota	9 pikë	19 pikë	4 pikë	32 pikë

Sipas tabelës së vlerësimit me notë (si në rastin e vlerësimit të testeve), vlerësimi i këtij portofoli është nota 10 (dhjetë).

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-8	9-13	14-18	19-23	24-27	28- 31	32-35

11.4 Vlerësimi me test ose detyrë përmbledhëse

Vlerësimi me test ose detyrë përmbledhëse ka për qëllim të matë nivelin e arritjeve të nxënësit për një grup të caktuar rezultatesh të nxëni. Mësuesi përzgjedh të zhvillojë test ose detyrë

përmbledhëse, në varësi të veçorive të lëndës. Testi përmbledhës është test që përmban vetëm rezultatet kryesore të të nxënësve (njohuritë dhe shkathtësitë) të periudhës përkatëse.

Si dhe kur realizohet testi ose detyra përmbledhëse?

- Në pjesën e fundit të periudhës kryhet ***vlerësimi me test ose me detyrë përmbledhëse***, që ka për qëllim të matë nivelin e arritjeve të nxënësve për një grup të caktuar rezultatesh të nxënësve për periudhën përkatëse.
- Mësuesi ka lirinë të përcaktojë vetë nëse do të zhvillojë test apo detyrë përmbledhëse sipas specifikave të lëndës.
- Testi/detyra përmbledhëse planifikohet nga mësuesi. Kur përmbyllet një grup rezultatesh të të nxënësve dhe mësuesi është ***i lirë ta vendosë vetë se kur do ta zhvillojë atë***.
- Testi/detyra përmbledhëse është 45 minuta.
- Drejtoria e shkollës menaxhon organizimin e testeve ose detyrave përmbledhëse sipas një grafiku, në mënyrë që të mos ngarkohet nxënësi në fund të periudhës.
- Testi/detyra përmbledhëse ***jo domosdoshmërisht*** bëhet në fund të periudhës. Mësuesi e përcakton vetë kohën se kur do ta zhvillojë atë.
- Në momentin kur mësuesi ***vlerëson testet/detyrat përmbledhëse, i vendos*** notat në regjistër.
- Mësuesi duhet ***të ruajë deri në përfundim të vitit shkollor*** testet ose detyrat përmbledhëse.

Hartimi i testit

Një nga format e vlerësimit të arritjeve të nxënësve në shkollë nga stafi drejtues është testi dhe Në raport me format e tjera të vlerësimit, kjo formë është me objektive dhe të krijon mundësinë:

- të përcaktosh nivelin e arritjeve të nxënësve për një periudhë të caktuar;
- të dallosh konceptet në të cilat nxënësit shfaqin dobësi;
- të monitorosh progresin ose jo, të nxënësve në raport me vlerësimin paraardhës;

Hapat për hartimin e një testi janë:

- ***Përcaktimi i rezultateve të të nxënësve të kompetencave dhe i koncepteve që do të vlerësohen*** (% e pikëve që do të zënë në test, e cila është në koherencë me % që kanë në programin e gjuhës shqipe).
- Përcaktimi i peshës së niveleve që do të zbatohet në test. Niveli i dytë i arritjes së kompetencave (***rekomandohet 40%***) përfshin pyetje ku kërkohet që nxënësi të zbatojë një procedurë rutinë, mjaft të ushtruar në klasë. Niveli i tretë i arritjes së kompetencave

(*rekomandohet 40%*) përfshin pyetje ku nxënësit nuk i mjafton të kujtojnë procedura rutinë, as të imitojnë zgjidhje standarde. Ai duhet të ndjehet para një situatë më komplekse, të cilën mund ta zgjidhë duke kombinuar njohuritë që disponon. Niveli i katërt i arritjes së kompetencave (*rekomandohet 20%*) përfshin pyetje ku nxënësi gjykon, zgjidh, jep mendim, vlerëson, harton etj., duke vënë në dispozicion njohuritë e tij.

- Ndërtimi i tabelës së specifikimeve (blueprintit)

Kompetencat	Përqindja = Pikët	Rezultatet e të nxënit	Niveli II i arritjes së kompetencave	Niveli III i arritjes së kompetencave	Niveli IV i arritjes së kompetencave
.....					
Pikët total të testit	100% = ... pikë		35% - 40% = ... pikë	35% - 40% = ... pikë	20% - 25% = ... pikë

- Hartimi i pyetjeve të testit.
- Përcaktimi i skemës së vlerësimit (*bazuar në shpërndarjen normale*). Sistemi i pikëzimit që përdoret më shumë është ai që quhet analitik. Dy nga elementet bazë të këtij sistemi janë:
 - caktimi i pikëve për konceptet që testohen;
 - skema e pikëzimit (*ku jepen kriteret e shpërndarjes së pikëve që janë përcaktuar për konceptet që do të testohen, duke pasur parasysh përgjigjen e saktë që duhet të jepet për këtë çështje*).

Në konvertimin e pikëve me nota, kufiri i poshtëm rekomandohet 25% e totalit të pikëve. Më pas caktohen intervalet e pikëve nga nota 4 – 10, të cilat janë si më poshtë

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Përqindja e pikëve	<25%	25-38%	39-51%	52-64%	65-77%	78-90%	91-100%

Pyetjet dhe llojet e tyre

Pyetjet në një test janë objektive, gjysmë objektive dhe subjektive. Pyetjet janë objektive, kur për to vlerësues të ndryshëm arrijnë në të njëjtin vlerësim, duke u bazuar në një çelës përgjigjesh të sakta. Pyetjet janë gjysmë objektive, kur përgjigja mund të jepet në formën e një fjalie të vetme ose të disa fjaltive. Ndërsa pyetjet subjektive kanë këto karakteristika:

- përgjigje të lira, të cilat mbështeten mbi një material;
- nuk ka kufizime në lidhje me gjatësinë ose stilin e përgjigjes (megjithëse kjo mund të përcaktohet në një farë mase);
- nuk kërkohet ndonjë strukturim i ngurtë i përgjigjes, megjithëse pyetja vetë duhet të jetë specifike dhe pa shumëkuptimësi.

Llojet e pyetjeve objektive

a) *Pyetjet me përgjigje alternative (pyetje me 2 variante zgjedhjeje) marrin përgjigjet:*

- po/jo;
- e vërtetë - e gabuar.

Shembull:

Kjo pjesë është përrallë.

V _____

G _____

b) *Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë (me alternativa)*

Këto pyetje japin një trung (rrënja) në formën e një pyetjeje apo të fjalie të paplotë dhe disa alternativa (tre ose katër), një prej të cilave është e vërtetë dhe pjesa tjetër janë alternativa hutuese. Këto pyetje janë të vlefshme për vlerësimin e njohurive, krahasime, zbatime të thjeshta, njohje e zbatim rregullash të thjeshta, formula e koncepte etj. Struktura e tyre është: trungu (rrënja), alternativat (përgjigjja e saktë dhe ç'orientuesit).

- Rekomandohen katër alternativa. Përdorimi i shumë alternativave do të ishte i pakuptimtë.
- Renditni alternativat sipas rendit alfabetik.
- *Trungu (rrënja) duhet të jetë një pyetje apo një pohim?* Të dyja strukturat janë të pranueshme. Disa hartues preferojnë të zgjedhin një strukturë dhe ta ruajnë atë vazhdimisht, por disa të tjerë i përdorin të dyja strukturat.

- Sigurohuni që trangu i pyetjes shpreh në mënyrë të plotë një çështje, në mënyrë që nxënësit të dinë mirë të bëjnë atë çfarë shpresohet prej tyre, para se të lexojnë alternativat.
- Shmangni përdorimin e fjalëve mohuese. Nxënësit në përgjithësi nuk e shohin “NUK” në një trung pyetjeje. Nëse ajo duhet përdorur patjetër është mirë ta dalloni duke e theksuar (*bold*) ose duke e kapitalizuar (NUK).
- Sigurohuni që të gjitha përgjigjet janë afërsisht në të njëjtën gjatësi, gramatikë apo vështirësi konceptimi.
- MOS jepni alternativa që janë pjesërisht të sakta ose i mbivendosen përgjigjes së saktë.
- MOS përdorni alternativat “*të gjitha më sipër*” apo “*A dhe B*”, të cilat e bëjnë pyetjen të vështirë në mënyrë të panevojshme për nxënësit.
- Përdorni udhëzime me gojë për ata që kanë vështirësi leximi.
- Përdorni shkronja të mëdha shtypi për të shënuar alternativat.

Shembull:

Cila nga fjalitë e mëposhtme tregon më së miri atë që ndodh mes elefantit dhe krokodilit në këtë ngjarje?

1 pikë

- A) Ata janë duke konkurruar me njëri-tjetrin.
- B) Ata kanë xhelozë për njëri-tjetrin.
- C) Ata janë mirënjohës ndaj njëri-tjetrit.
- D) Ata janë dashamirës për njëri-tjetrin.

c) Pyetjet me plotësim

Këto janë pyetje në formën e një fjalie që i mungon një pjesë, e cila mund të jetë fjalë a togfjalësh. Mund të jetë edhe një pjesë teksti, me pjesë të paplotësuara. Vendosja e pjesëve të munguara i jep kuptimin e duhur fjalisë apo tekstit kuptimin e plotë. Ndërtimi i fjalës në mënyrë që përgjigja e vërtetë të jetë e shkurtër dhe vetëm një. Pjesën që mungon është më mirë ta vendosim në fund të fjalisë se në fillim të saj.

Shembull: Në muret e kalasë së Shkodrës u muros _____

d) Pyetjet me kombinime (me çiftime)

Në këto pyetje:

- zgjidhen çifte fjalësh që kombinohen nga dy lista të dhëna;

- nxënësi duhet të bëjë lidhjen korrekte mes tyre;
- variantet e dhëna në një anë duhet të jenë më të shumta se në anën tjetër.

Pyetjet gjysmë objektive

Këto pyetje kërkojnë përgjigjen e një pyetjeje direkt ose plotësim të një fjalie të paplotë. P.sh.:
Fabula është _____

Pyetjet subjektive

a) Eseja e strukturuar:

- ka për qëllim kufizimin e përgjigjes;
- forma e përgjigjes kufizohet nga mënyra sesi ndërtohet pyetja. P.sh.: *Përshkruaj në jo më shumë se 100 fjalë personazhin e Rinës në rrëfënjën “Rinë Katerinëza” të Kutelit ”*

b) Eseja e pastrukturuar i jep mundësi nxënësit të demonstrojë:

- aftësi në përdorimin e gjuhës;
- fuqinë e analizës;
- aftësi në përzgjedhjen e përgjigjes;
- aftësi argumentuese;
- etj.

Kërkesa e esesë duhet të jetë sa më e qartë. Për këtë ka rëndësi folja e përdorur: përshkruaj, shpjego, vlerëso... etj.

Pikët dhe kriteret e pikëzimit

Pikët janë **tregues të nivelit të arritjeve**. Qëllimi i vendosjes së tyre është marrja dhe dhënia e informacionit në lidhje me arritjet e nxënësve. **Sistemi analitik** është më i përshtatshmi për pikëzim. Ai bazohet në vendosjen e pikëve për elemente të caktuara të përgjigjes. **Sistemi analitik** i pikëzimit ka **2 kërkesa**: caktimi i pikëve për çdo pyetje të testit dhe hartimi i skemës së pikëzimit.

Vlerësimi me pikë i pyetjeve objektive dhe gjysmë objektive

- Pyetjet po/jo; e vërtetë/ e gabuar vlerësohen me 1 pikë.
- Pyetjet me çiftim; për çdo çiftim të saktë nxënësi merr 1 pikë
- Pyetjet me plotësim: për çdo plotësim nxënësi merr 1 pikë.
- Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë: për çdo përgjigje të saktë nxënësi merr 1 pikë.
- Pyetjet me përgjigje të shkurtër: për çdo kërkesë nxënësi merr 1 pikë.

P.sh.: për pyetjen me 2 pikë “Gjeni figurën letrare dhe tregoni funksionin e saj”, nxënësi:

- vlerësohet me 0 pikë nëse nuk jep asnjë përgjigje;
- vlerësohet me 1 pikë, nëse gjen vetëm figurën letrare;
- vlerësohet me 2 pikë nëse gjen figurën letrare dhe funksionin e saj.

Llogaritja e kohës së testit

Mësuesi duhet të vlerësojë kohën që i duhet nxënësit për t’iu përgjigjur të gjitha pyetjeve. Mbi këtë kohë ai duhet të shtojë kohë, për efekt të faktorëve të mëposhtëm:

- Nxënësi është më i ngadaltë në procedurat e përgjigjeve dhe të zgjidhjeve.
- Nxënësi është nën presion.
- Nxënësi bën gabime dhe shpesh duhet t’i rikthehet zgjidhjes së saktë.
- Nxënësi përgjithësisht ndjek rrugë më të gjatë zgjidhje dhe arsyetimi.
- Nxënësi shpesh verifikon për herë të dytë ose më tepër përgjigjet ose zgjidhjet.
- Mësuesi duhet të ketë parasysh që të shmangë zgjatjet e panevojshme.

Shumë nga vlerësimet e shkurtra (pak pyetje) mund të na japin një pamje më të saktë të asaj çfarë nxënësi di në krahasim me një vlerësim të gjatë (shumë pyetje). E thënë më ndryshe duhet të shmangim zgjatjen e panevojshme të një testi. Zgjatja e panevojshme të shmang nga qëllimi kryesor, krijon konfuzion dhe presion për nxënësin. Mësuesi duhet të konsiderojë një sërë faktorësh të tjerë si socialë e psikologjikë, që lidhen me kohën, vendin, rëndësinë e testit, si dhe me moshën, gjininë dhe përkatësinë kulturore-sociale të nxënësit.

Më poshtë është dhënë një talelë orientuese për kohën që i duhet nxënësit për një pyetje ose kërkesë në test.

Lloji i pyetjes	Koha e përafërt
Pyetje me <i>po/jo</i> ose me <i>e vërtetë/ e gabuar</i>	20-30 sekonda

Pyetje me alternativa	40-60 sekonda
Pyetje me plotësim (1 fjalë ose disa grup fjalësh)	40-60 sekonda
Pyetje me kombinime (me çiftime)	2-4 minuta
Pyetje me përgjigje të shkurtra	2-4 minuta
Ese me përgjigje të kufizuar	15-20 minuta
Ese me përgjigje të zgjeruar	35-50 minuta

Modele testesh (45 minuta)

Klasa VI

Periudha: ...

Testi ka 30 pikë

Në test vlerësohen:

- Të lexuarit e teksteve letrare
- Të shkruarit
- Përdorimi i drejtë i gjuhës

Përqindja e pikëve përcaktohet duke iu referuar afërsisht peshës që kanë në program.

Të lexuarit e teksteve letrare (70 orë)

Të shkruarit (25 orë)

Përdorimi i drejtë i gjuhës (60 orë)

Plotësimi i tabelës së specifikimeve

Kompetencat	Pikët	Rezultatet e të nxënit	Niveli II i arritjes së kompetenca ve	Niveli III i arritjes së kompete ncave	Niveli IV i arritjes së kompeten cave

Të lexuarit	13 pikë	- identifikon kohën e ngjarjeve; - dallon kuptimin e fjalëve; - lidh personazhet me jetën e tij; - dallon figurën letrare;	P2;P5; P6; P8. (4 pikë)		
		- emërton llojin e tekstit; - analizon personazhet; - përcakton elementet e strukturës së tekstit (hyrje, zhvillim dhe mbyllje); - përcakton qëllimin e tekstit;		P1; P3; P7; P4. (7 pikë)	
		- gjykon veprimet e personazheve.			P3; P8. (2 pikë)
Të shkruarit	4 pikë	zbaton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit	P9. (1 pikë)		
		shkruan një fund tjetër të logjikshëm për tekstin;			P9. (3 pikë)
Përdorimi i drejtë i gjuhës	13 pikë	dallon kallëzuesin; dallon fjalinë e thjeshtë; gjen kryefjalën; dallon klasat e fjalëve;	P10; P14, P13; P17. (6 pikë)		
		dallon fjalinë e përbërë me nënrenditje; tregon me se shprehet kryefjala; përcakton funksionin e fjalëve në fjali		P11;P13; P15 (4 pikë)	
		formon fjali bashkërenditëse shtuese formon fjali me ndajtshtim dhe përcaktor			P12; P16 (3 pikë)
Pikët total të testit	100% = 30 pikë		11 pikë 37%	11 pikë 37%	8 pikë 26%

Test: Periudha ...
Lënda: Gjuhë shqipe
Klasa: VI

Djaloshi dhe shqiponja

(krijim folklorik)

Kur po binte gjethi, një i ri kishte dalë për gjah në male. Një shqiponjë që vinte rrotull mbi kokën e tij, ndali në një shkrep shkëmbor. Kjo shqiponjë që ishte jashtëzakonisht e bukur, kishte mbërthyer për sqepi një gjarpër. Pas pak, shqiponja u ngrit sërish fluturimthi nga kreshta dhe u drejtua për andej nga kishte folenë.

Djaloshi u mbërthye nëpër shkëmbinj dhe u ngjit lart deri në majën e shkëmbit ku ndodhej foleja e shqiponjës. Aty pa të voglin e shqiponjës duke luajtur me gjarpurin e plagosur. Në një moment gjarpri lëvizi me shpejtësi trupin duke nxjerrë dhëmbët e vegjël, gati për të futur në trupin e zogut të shqiponjës, helmin e vet të tmerrshëm.

Me shpejtësi dhe me guxim, djaloshi rrëmbeu zogun e shqiponjës dhe iu drejtua rrugës së kthimit për në shtëpi.

Papritur djali gjuetar ndjeu mbi kokë një rrahje kërcënuese krahësh dhe një hije e madhe e zezë e mbuloi. Ishte shqiponja nënë që qëndroi përballë tij.

- Përse e rrëmbeve tim bir? - klithi rëndë Shqiponja.

- I vogli tani është imi, sepse e shpëtova nga gjarpri, - iu përgjigj djali

- Më kthe djalin tim, - gjëmoi shpendi i madh, - dhe në këmbim unë do të të jap mprehtësinë e syve dhe forcën e krahëve të mi. Ti do të bëhesh i pamposhtur dhe do të njihesh nën emrin tim.

Marrëveshja u pranua. Djali i ri dorëzoi të voglin e shqiponjës. Kjo e fundit u rrit dhe fluturon gjithmonë mbi kokën e djalit, pranë tij. Djaloshi u bë një burrë i madh i fortë që luftonte bishat e egra dhe armiqtë e atyre anëve.

Gjatë gjithë këtyre përpjekjeve të tij, shqiponja besnike e shihte dhe e udhëhiqte nga lart. Të mahnitur nga kjo bashkëjetesë e pazakontë e gjuetarit të njohur me shpendin e bukur, njerëzit nisën ta quanin atë djalë dhe pasardhësit e tij me emrin "Shqiptar", që do të thotë Bir i Shqiponjës dhe mbretërinë e tij, Shqipëri, ose Toka e Shqiponjave.

Lexoni me vëmendje tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.

1. Ky tekst është:

1 pikë

- A) tregim;
- B) legjendë;
- C) gojëdhënë;
- D) fabul.

2. Ngjarjet zhvillohen gjatë:

1 pikë

- A) dimrit;
- B) pranverës;
- C) vjeshtës;
- D) verës.

3. Kjo pjesë ka për qëllim të rrëfejë: 1 pikë

- A) zemërgjerësinë dhe shpirtmadhësinë e njeriut ndaj kafshëve;
- B) që gjarpërinjtë përfaqësojnë dinakërinë dhe të keqen;
- C) që bota shtazore ka të njëjtat ndjenja si ajo njerëzore;
- D) origjinën e emrit “shqiptar”.

4. Nënvizoni në tekst hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen. 3 pikë

5. Gjeni figurën letrare të përdorur në shprehjen “një rrahje kërcënuese krahësh”. 1 pikë

6. Cili është kuptimi i fjalës “klithi” në fjalinë “... klithi rëndë Shqiponja”. 1 pikë

7. Shkruani një tipar të djalit dhe një të shqiponjës. 2 pikë

8. Si e gjykoni veprimin e shqiponjës në fragmentin e mëposhtëm? Ju çfarë do të kishit bërë në vendin e saj? 3 pikë

“Më kthe djalin tim, - gjëmoi shpendi i madh, - dhe në këmbim unë do të të jap mprehtësinë e syve dhe forcën e krahëve të mi. Ti do të bëhesh i pamposhtur dhe do të njihesh nën emrin tim”.

9. Shkruani një fund tjetër për tekstin duke ndjekur linjën logjike të tij. 4 pikë

10. Dalloni fjalinë e thjeshtë në fragmentin e dhënë. 1 pikë

- A) Në një moment gjarpri lëvizi me shpejtësi trupin duke nxjerrë dhëmbët e vegjël.
- B) Me shpejtësi dhe guxim, djaloshi rrëmbeu shpendin dhe shpëtoi zogun e shqiponjës.
- C) Pastaj mori shqiponjën e vogël dhe iu drejtua rrugës së kthimit në shtëpi.
- D) Kur po binte gjethi, një i ri kishte dalë për gjah në male.

11. Në fjalitë e mëposhtme qarkoni fjalinë e përbërë me nënrenditje. 1 pikë

- A) Ai lëvizi me shpejtësi trupin, gati për të injektuar në trupin e shqiponjës, helmin e vet të tmerrshëm.
- B) Djaloshi nxori harkun dhe shigjetën, qëllloi mbi gjarprin dhe e vrau atë.
- C) Papritur djali gjuetar ndjeu mbi kokë një rrahje kërcënuese krahësh dhe një hije e madhe e mbuloi.
- D) Ishte shqiponja nënë që qëndroi përballë tij.

12. Formoni një fjali me bashkërenditje shtuese. 1 pikë

13. Identifikoni kryefjalën në fjalinë e mëposhtme dhe thoni me se shprehet. 2 pikë
Një djalë dorëzoi shqiponjën e vogël.

14. Gjeni kallëzuesin e fjalisë së mëposhtme. 1 pikë
Kjo shqiponjë ishte jashtëzakonisht e bukur.

15. Për fjalët e nënvizuara përcaktoni funksionin e tyre në fjali. 2 pikë
Aty pa të voglin e shqiponjës duke luajtur me gjarprin e ngordhur.

16. Formoni fjali ku fjala shqiptar të përdoret një herë si ndajshtim dhe një herë si përcaktor me drejtim. 2 pikë

17. Thoni klasat e fjalëve të nënvizuara. 3 pikë
Në një moment ai lëvizi me shpejtësi trupin duke nxjerrë dhëmbët e vegjël.

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-7	8- 11	12-15	16- 19	20- 23	24-27	28-30

Klasa VII

Periudha: ...

Testi ka 30 pikë

Në test vlerësohen:

- Të lexuarit e teksteve joletrare
- Të shkruarit
- Përdorimi i drejtë i gjuhës

Përqindja e pikëve përcaktohet duke iu referuar afërsisht peshës që kanë në program.

Të lexuarit e teksteve letrare (70 orë) 14 pikë

Të shkruarit (25 orë) 3 pikë

Përdorimi i drejtë i gjuhës (60 orë) 13 pikë

Kompetencat	Pikët	Rezultatet e të nxënit	Niveli II i arritjes së kompetencave	Niveli III i arritjes së kompetencave	Niveli IV i arritjes së kompetencave
Të lexuarit	14 pikë	- përcakton llojin e tekstit - përcakton kohën e ngjarjes; - gjen një figurë letrare; - lidh jetën e tij me ngjarjen e tekstit.	P1; P2; P7; P10. (5 pikë)		
		- përcakton llojin e tekstit; - analizon personazhin; - analizon tekstin;		P1; P4; P5; P9. (6 pikë)	
		- jep gjykime për tekstin; - identifikimi i idesë kryesore.			P3; P6. (3 pikë)
Të shkruarit	3 pikë	- përshkruan portretin e personazhit.			P11. (3 pikë)
Përdorimi i drejtë i gjuhës	13 pikë	- gjen antonimet; - dallon kuptimin e fjalëve; - përcakton klasën e fjalëve.	P7; P8; P15. (5 pikë)		
		- përcakton shkallën e mbiemrit; - dallon llojin e		P12; P13; P14; P16; P17	

		përemrit; - dallon foljen dhe kohën e saj; - gjen trajtën e shkurtër.		(6 pikë)	
		- përcakton rasën e trajtës së shkurtër; - formon fjali me formë të pashtjelluar.			P17; P18. (2 pikë)
Pikët total të testit	100% = 30 pikë		10 pikë 34%	12 pikë 40 %	8 pikë 26%

Test: Periudha

Lënda: Gjuhë shqipe

Klasa: VII

Letra e Abraham Linkolnit për mësuesin e djalit të tij.

Mësues i nderuar,

Im bir fillon shkollën sot. Pas pak, gjithçka për të do të jetë e çuditshme dhe e re, prandaj do të doja ta trajtonit atë butësisht. Është një aventurë që do ta marrë me vete nëpër të gjitha kontinentet. Të tilla aventura ndoshta mund të përfshijnë luftëra, tragjedi dhe fatkeqësi. Ta jetosh këtë jetë duhet besim, dashuri dhe kurajë.

Për këtë, i dashur mësues, do t'ju lutesha ta merrnit përdore e t'i mësoni gjëra që do t'i duhen t'i dijë, por butësisht nëse mundeni.

Mësojeni se për çdo armik ekziston një mik.

Mësojeni se jo të gjithë njerëzit janë të drejtë dhe se jo të gjithë njerëzit janë të sinqertë. Megjithatë, mësojeni se për çdo faqezi ka një hero dhe se për çdo politikan egoist ka një lider të përkushtuar.

Mësojeni nëse mundeni se 10 centë të fituar kanë shumë më tepër vlerë se një dollar i gjetur. Në shkollë, mësues, është shumë më e ndershme të dështosh se të mashtrosh.

Mësojeni atë si të humbë hijshëm dhe si t'i gëzohet fitores kur ai fiton.

Mësojeni të jetë i mirë me njerëzit e mirë dhe i ashpër me njerëzit e ashpër. Mundohuni t'i qëndrojnë sa më larg zilisë, nëse do të mundeni dhe mësojini sekretin e një buzëqeshjeje të çiltër.

Mësojeni, po të jetë e mundur, si të qeshë kur të jetë i trishtuar dhe se të derdhësh lot nuk është aspak turp.

Mësojeni se mund të ketë dështim të ndershëm dhe fitore të turpshme.

Mësojeni t'i përqeshë cinikët.

Mësojeni nëse mundeni, që të zbulojë mrekullinë e leximit të librave, por gjithashtu, jepini edhe kohën e mjaftueshme për të kundruar misterin e përjetshëm të fluturimit të zogjve në qiell, të bletëve në diell e të luleve mbi një kodër të gjelbër.

Mësojeni të këtë besim në idetë e tij edhe nëse të gjithë do t'i thonë se janë të gabuara.

Mundohuni t'i mësoni birit tim forcën për mos e ndjekur turmën edhe kur të gjithë vrapojnë pas fitimtarit.

Mësojeni të dëgjojë me vëmendje çdo njeri, por gjithashtu të shoshitë të gjithë atë që dëgjon në sitën e të vërtetës dhe të marrë veç të mirën.

Lejojeni të ketë kurajën për të qenë i padurueshëm. Lejoheni të ketë durimin për të qenë trim.

Mësojeni atë të ketë besim të plotë te vetvetja, sepse vetëm atëherë ai do të ketë besim të plotë të njerëzimi.

Këto janë kërkesat, mësues, por ju bëni më të mirën që mundeni. Ai është një fëmijë i vogël dhe i mirë. Dhe është biri im.

Lexoni tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.

1. Teksti i mësipërm është: 1 pikë

- A) një letër zyrtare;
- B) një faqe nga ditari i presidentit;
- C) një letër personale;
- D) një letër e hapur.

2. Letra e Linkoln është shkruar: 1 pikë

- A) për ditën e parë të shkollës;
- B) për përfundimin e vitit shkollor;
- C) në mes të vitit shkollor;
- D) gjatë pushimeve verore.

3. Sipas Abraham Linkoln, mësuesi në shkollë duhet të përqendrohet: 1 pikë

- A) në përvetësimin e njohurive të sakta nga nxënësit;
- B) në zhvillimin e aktiviteteve shkollore argëtuese;
- C) në ndërtimin aftësive dhe vlerave që u duhen nxënësve për jetën;
- D) në ndërtimin e marrëdhënieve korrekte mes nxënësve në klasë.

4. Linkoln kërkon që mësuesi ta edukojë të birin: 1 pikë

- A) sipas dëshirës së vetë djalit;
- B) duke e trajtuar si të veçantë;
- C) butësisht, por sipas normave;
- D) rreptësisht në pjesën më të madhe të kohës.

5. Lidhni tiparin me shprehjen e Linkoln. 3 pikë

- | | |
|-----------------|---|
| a) I ndershëm | Mësojeni të ketë besim në idetë e tij dhe kur i thonë se janë të gabuara. |
| b) I drejtë | Mësojeni se 10 centë të fituar kanë më tepër vlerë se një dollar i gjetur. |
| c) Me vetëbesim | Mësojeni të jetë i mirë me njerëzit e mirë dhe i ashpër me njerëzit e ashpër. |
| d) Këmbëngulës | |

6. Çfarë nënkupton shkruesi i letrës në këtë fragment? 2 pikë
“Mësojeni nëse mundeni, të zbulojë mrekullinë e leximit të librave, por gjithashtu, jepini edhe kohën e mjaftueshme për të kundruar misterin e përjetshëm të fluturimit të zogjve në qiell, të bletëve në diell e të luleve mbi një kodër të gjelbër”

7. Cila është figura letrare që përdoret më shumë në këtë tekst? Cili është mjeti gjuhësor me të cilin është realizuar? 2 pikë

8. Cili është kuptimi i foljes “shoshit” sipas fragmentit të mëposhtëm? 1 pikë
“...Të shoshitë të gjithë atë që dëgjon në sitën e të vërtetës dhe të marrë veç të mirën”.

9. Gjeni në këtë letër: 2 pikë
 a) formulën e hapjes:-----
 b) përfundimin:-----
10. Shprehni dy kërkesa për mësuesit ose për shkollën tuaj. 2 pikë

11. Përshkruani shkurtimisht portretin e mësuesit tuaj të parë. 3 pikë

12. Mbiemri i nënvijuar në fjalinë “Në shkollë, është shumë më e ndershme të dështosh se të mashtrosh” është në shkallën: 1 pikë
 A) pohore;
 B) krahasore e sipërisë;
 C) sipërore;
 D) krahasore e barazisë.
13. Në fjalinë “Këto janë kërkesat, mësues, por ju bëni më të mirën që mundeni.”, fjala e nënvizuar është përemër: 1 pikë
 A) vetor;
 B) pronor;
 C) i pacaktuar;
 D) dëftor.
14. “Ju” , në fjalinë “ *Ju bëni më të mirën*” është: 1 pikë
 A) Pjesëz;
 B) përemër vetor;

- C) trajtë e shkurtër;
D) pasthirmë.

15. Cilës klasë i përkasin fjalët e nënvizuara? 3 pikë
Pas pak, gjithçka për të do të jetë e çuditshme dhe e re, prandaj do të doja ta trajtonit atë butësisht.

16. Dalloni foljen në mënyrën lidhore dhe përcaktoni kohën e saj. 2 pikë
Lejoheni të ketë durimin për të qenë trim.

17. Në fjalinë e dhënë gjeni trajtën e shkurtër dhe thoni rasën. 2 pikë
Mësojeni se mund të ketë dështim të ndershëm dhe fitore të turpshme.

18. Ndërttoni një fjali ku të përdorni formën e pashtjelluar përcjellore të foljes “*mësoj*.” 1 pikë

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-7	8- 11	12-15	16- 19	20- 23	24-27	28-30

11.5 Vlerësimi periodik

Vlerësimi periodik bëhet në përfundim çdo periudhe dhe përmban tri nota:

- *Nota e vlerësimit të vazhdueshëm (NVv)*, e cila vendoset në regjistër në kolonën përkatëse në faqet e vlerësimit.
- *Nota e vlerësimit me test ose me detyrë përmbledhëse (NTp)*, e cila vendoset në regjistër në kolonën përkatëse në faqet e vlerësimit.
- *Nota e vlerësimit të portofolit lëndor (NVp)*, e cila vendoset në regjistër në kolonën përkatëse në faqet e vlerësimit.

11.6 Vlerësimi përfundimtar

Vlerësimi përfundimtar shënohet në regjistër duke plotësuar kolonat “Vlerësimi vjetor” dhe në kolonën “Nota përfundimtare”.

Vlerësimet vjetore përmbajnë:

- notën vjetore të vlerësimit të vazhduar që është rezultat i tri periudhave;
- notën vjetore të vlerësimit me test ose detyrë përmbledhëse që është rezultat i tri periudhave;
- notën vjetore të vlerësimit të dosjes së nxënësit që është rezultat i tri periudhave.

Në rast kur ecuria e nxënësit është e dukshme progresive ose regressive gjatë dy periudhave të fundit, vlerësimi i tij vjetor në secilën nga rubrikat mund të jetë progresiv ose regresiv.

Në rast se ecuria e tij nuk është e qëndrueshme përgjatë tri periudhave, atëherë vlerësimi llogaritet me mesatare.

Nota përfundimtare llogaritet me përqindje për secilën nga rubrikat

Tabela: Pesha në përqindje e llojeve të vlerësimit

Lloji i vlerësimit	Pesha në përqindje
Vlerësimi i vazhdueshëm	40%
Vlerësimi me test ose detyrë përmbledhëse	40%
Vlerësimi i portofolit të nxënësit	20%

Hapat për njehsimin e notës përfundimtare janë:


- Përcaktohet nota vjetore e vlerësimit të vazhduar (NV_V), bazuar në tri notat e periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive.
- Përcaktohet nota vjetore e testit/detyrës përmbledhëse (NT_P) bazuar në tri notat e periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive.
- Përcaktohet nota vjetore e portofolit të nxënësit (NV_P) bazuar në tri notat e periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive.
- Shumëzohet secila prej notave me përqindjen përkatëse.
- Mblidhen këto prodhime dhe shuma rrumbullakoset me numër të plotë (p.sh., 8,8 $\approx$ 9).

$$(NV_V \times 0.4) + (NT_P \times 0.4) + (NV_P \times 0.2) = \text{Nota përfundimtare}$$

Përshkrimi i notës përfundimtare vjetore argumenton nivelin e arritjeve të kompetencave të fushës/lëndës. Përshkrimi i referohet pikave më të forta që ka nxënësi lidhur me përmbushjen e kompetencave të lëndës

Shembull 1: Gjuhë shqipe, klasa VII

Tremujori I			Tremujori II			Tremujori III			Notat vjetore			Nota përfundimtare
NV V	NT _P	NV P	NV V	NT _P	NV P	NV V	NT _P	NV P	NV V	NT _P	NV P	8
7	6	7	8	7	8	8	7	9	8	7	8	



$$(8 \times 0.4) + (7 \times 0.4) + (8 \times 0.2) = 7.6$$

Nota përfundimtare 8

Nota përfundimtare	Përshkrimi i vlerësimit
8	Arbri... kupton, interpreton, analizon mirë tekste të ndryshme letrare dhe jolettrare, si dhe jep disa gjykime rreth tyre. Ai shkruan duke u përqendruar në temën që do të trajtojë dhe lidh mirë fjalitë në paragraf e paragrafët mes tyre. Ai përdor mirë gjuhën standarde dhe zbaton rregullat gramatikore e drejtshkrimore.

11.8 Vlerësimi i esesë

Ndryshe nga një ushtrim matematike apo fizike që ka një zgjidhje të vetme, një ese përbëhet nga një numër i shumtë elementesh. Më poshtë janë renditur dy modele sugjeruese për vlerësimin e esëve.

Model 1

Nota 10

Një ese duhet vlerësuar me notën 10, kur është shumë origjinale, është jashtëzakonisht e strukturuar dhe e detajuar, ka një rrjedhë logjike mendimi dhe është shumë bindëse (mund të ketë një ose dy gabime sipërfaqësore).

Kjo ese:

- i përmbahet temës, e cila zhvillohet dhe mbështetet me shembuj, ilustrime, fakte ose detaje të shumta;

- ka strukturë të qartë dhe organizim logjik;
- ka strukturë të saktë të paragrafëve;
- ka rrjedhë logjike midis fjalive dhe paragrafëve;
- ka strukturë të saktë të fjalive;
- ka përdorim të saktë dhe të përshtatshëm të gjuhës shqipe standarde (nuk ka fjalë të huaja, trajta të ligjërit bisedor, fjalë dialektore etj.), duke përfshirë edhe shenjat e pikësimit dhe rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore;
- ka origjinalitet dhe stil në mendimet dhe idetë e shprehura.

Nota 9

Një ese vlerësohet me notën 9, kur tema është trajtuar mirë dhe ka një strukturë të organizuar. Kjo ese nuk ka aq origjinalitet dhe stil sa një ese e cila vlerësohet me notën 10, por është e qartë dhe interesante (mund të ketë disa gabime sipërfaqësore, që nuk e prekin kuptimin e fjalive).

Kjo ese:

- i përmbahet temës, por mund të ketë nevojë për disa shpjegime apo argumente shtesë;
- ka strukturë të qartë dhe organizim logjik;
- ka strukturë të qartë të paragrafëve;
- ka rrjedhë të mirë logjike midis fjalive dhe paragrafëve;
- fjalitë kanë strukturë të saktë;
- ka përgjithësisht përdorim të saktë të gjuhës shqipe standarde (nuk ka fjalë të huaja, trajta të ligjërit bisedor, fjalë dialektore etj.), duke përfshirë edhe shenjat e pikësimit dhe rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore;
- ka më pak origjinalitet dhe stil sesa një ese që vlerësohet me notën 10.

Notat 7 dhe 8

Kjo është një ese, e cila tregon aftësitë e nxënësit për të shkruar në gjuhën shqipe standarde, por nuk e ka origjinalitetin dhe rrjedhshmërinë e esesë që vlerësohet me notën 10 dhe nuk ka zhvillimin dhe organizimin e esesë që vlerësohet me notën 9. Dallimet kryesore midis notës 7 dhe 8 janë sasia e detajeve të përdorura për të zhvilluar kryesore, si dhe rëndësia që i jepet trajtimit të temës. Gabimet drejtshkrimore, gramatikore apo në përdorimin e shenjave të pikësimit hasen më shpesh në këto ese.

Kjo ese:

- përgjithësisht i përmbahet temës, e cila mbështetet me detaje të rëndësishme (ndonjëherë këto detaje mund të mungojnë);
- ka strukturë të mirë (mund të ketë disa gabime në strukturimin e esesë);
- ka organizim të mirë të paragrafëve (mund të ketë disa gabime në strukturimin e paragrafëve);
- ka rrjedhë logjike midis fjalive dhe paragrafëve, por ndonjëherë mund të mungojë;
- fjalitë kanë strukturë të mirë, por mund të ketë fjalë apo fjali që përsëriten;
- ka përdorim të saktë të gjuhës standarde, por ka edhe përdorim të disa fjalëve dialektore ose fjalë të ligjërimit bisedor;
- ka pak gabime gramatikore, drejtshkrimore apo në vendosjen e shenjave të pikësimit;
- ka më pak origjinalitet dhe stil sesa një ese që vlerësohet me notën 9 ose 10.

Notat 5 dhe 6

Kjo ese vlerësohet me notën 5 ose 6, sepse ka një strukturë të dobët dhe mungojnë detajet që mbështesin argumentet dhe idetë e shfaqura. Në këtë ese mund të shohim që nxënësi shpesh largohet nga tema.

Në këtë ese:

- trajtimi i temës është i paqartë ose i papërshtatshëm në lidhje me lexuesin;
- nxënësi nuk jep fakte apo detaje për të mbështetur argumentet e tij;
- paragrafët dhe fjalitë përgjithësisht nuk kanë një rend logjik;
- ka disa fjali që nuk kanë strukturë të saktë;
- ka fjalë që përdoren gabimisht dhe vihen re shumë dialektizma, klishe etj.;
- ka gabime të shpeshta drejtshkrimore, gramatikore dhe në vendosjen e shenjave të pikësimit;
- origjinaliteti në trajtimin e temës, pothuajse mungon.

Nota 4

Një ese vlerësohet me notën 4 sepse:

- tema nuk trajtohet përgjatë esesë;
- nuk ka strukturë (nuk ka hyrje, zhvillim dhe mbyllje);
- nuk është e strukturuar në paragrafë;
- nuk ka rrjedhë logjike midis fjalive;
- nuk përdoret gjuha shqipe standarde;
- ka gabime të rënda drejtshkrimore, gramatikore dhe në përdorimin e shenjave të pikësimit;

- nuk ka aspak origjinalitet në idetë e shprehura.

Model 2

Kriteret për vlerësimin e eseve

Kriteri 1: ideja dhe argumentimi 2 pikë

Mësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- e ka kuptuar qartë nga pikëpamja përmbajtësore dhe artistike tekstin e dhënë;
- interpreton në mënyrë analitike pjesën;
- i mbështet idetë e veta me shembuj nga teksti i dhënë;
- përdor detaje mbështetëse;
- ka qartësi mendimi.

Kriteri 2: struktura e esesë 1 pikë

Mësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- respekton elementet e strukturës së esesë:
- hyrjen
- zhvillimin
- përfundimin

Nxënësi merr 1 pikë nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme. *Nëse mungon njëra prej tyre, ai do të marrë 0 pikë për këtë rubrikë.*

Mësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shprehet me një gjuhë eseistike;
- ka fjalor të pasur;
- stil origjinal;
- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore dhe fjalëformimi.

Kriteri 4: Larmia sintaksore 1 pikë

Mësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- zotëron sintaksën;
- ka aftësi për të ndërtuar fjali që janë të sakta;
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm;
- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja sintaksore.

Kriteri 5: Saktësia drejtshkimore 1 pikë

Mësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- ka saktësi drejtshkimore;
- përdor si duhet shkronjën e madhe;
- përdor si duhet shenjat e pikësimit.

11.9. Ndryshime pozitive që sjell vlerësimi i bazuar në kompetenca

Për nxënësit	Për mësuesit	Për prindërit
Vlerësimi i bazuar në kompetenca:		
Siguron informacion për pikat e forta dhe mundësitë për zhvillim.	Siguron të dhëna të hollësishme për aspekte të ndryshme të të nxënësit.	Siguron informacion të detajuar dhe specifik për arritjet e fëmijës.
Mbështet dhe nxit procesin e të nxënësit.	Krijon mundësi të gjykojë më mirë për arritjet e nxënësve.	Krijon mundësi që prindërit të përfshihen në procesin e të nxënësit të fëmijës.
Lehtëson nxënësit dhe shmang presionin e notës në mënyrë të vazhdueshme.	Lehtëson vëmendjen e tij nga notat e vazhdueshme duke u përqendruar më shumë te të nxënësit e nxënësve.	Krijon më shumë mundësi për mbështetje rreth të nxënësit të fëmijëve të tyre.
Ç bën “mitin” e notës.	Shmang subjektivizmin në vlerësim.	Krijon mundësi që prindërit të interesohen më shumë për

		përparimin e nxënësve në vazhdimësi.
Siguron vetëbesim të nxënësit.	Siguron të dhëna nga burime të ndryshme për të motivuar nxënësin.	Krijon mundësi që të vlerësohen jo vetëm arritjet, por edhe përpjekjet që bëjnë fëmijët e tyre.
Krijon mundësi për vetëvlerësim dhe forma të larmishme vlerësimi.	Me organizimin e veprimtarive gjithëpërfshirëse gjatë zhvillimit të mësimi me dy orë të njëpasnjëshme lehtësohet shumë si proces.	Krijon mundësi që prindërit të japin mendimin e tyre për vlerësimin e fëmijës së tyre.
Motivon zhvillimin e kompetencave të nxënësit (kompetencave kyç dhe lëndore).	Nxit rritjen profesionale të mësuesit.	Krijon mundësi që fëmijët e tyre të aftësohen edhe në zgjidhjen e situatave në jetën e përditshme.
Bazohet në nivele arritjesh të njëjta për të gjithë.	Krijon mundësi që mësuesi të jetë objektiv dhe transparent për të gjithë.	Krijon mundësi që prindërit të ndërgjegjësohen për vlerësimin e fëmijës së tyre.
Zhvillon talente dhe u jep mundësi të gjithë nxënësve të tregojnë aftësitë e tyre.	Siguron gjykime dhe mbështet vendimmarrje mbi bazën e të dhënave të shumta që siguron.	Krijon mundësi që prindërit të sigurojnë informacione mbi bazën e të dhënave që mësuesi siguron nga burime të ndryshme.
E bën nxënësin më “miqësor” me lëndën.	E bën lëndën më “të dashur” për nxënësin.	E bën shkollën dhe mësuesit më “të pëlqyeshëm” për fëmijët e tyre.

Bibliografia

- IZHA, 2014, Korniza kurrikulare.
- IZHA, 2014, Kurrikula bërthamë AMU, klasat 6-9.
- IZHA, 2014-2018, Programet me kurrikulën e bazuar në kompetenca, klasat 6-7 -8 -9
- IZHA, 2015, Korniza e vlerësimit të nxënësit.
- IZHA, 2016, Nivelet e arritjes (arsimi bazë).
- IZHA, 2017, Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët.
- OECD, Programme for International Student Assessment (PISA).
- Vaça, R, Vaça, J. 2009, Content Area Reading (Pearson International Edition)
- Topkins, E, G, 2006, Literacy for the 21-th century (Pearson).
- Musai, B. Mësimdhënia dhe të nxënit ndërveprues (CDE).
- Musai, B. Si të shkruajmë ese (CDE).
- Topkins, E, G, 2008. Teaching Writing (Pearson).
- http://eacea.ec.europa.eu/education/eurydice/documents/thematic_reports/109EN.pdf
- http://eacea.ec.europa.eu/education/eurydice/documents/thematic_reports/130EN.pdf
- <https://data.oecd.org/pisa/reading-performance-pisa.htm>.